



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 208

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 12 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 114/2024, datë 14.11.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron përmes Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për projektin “Bashki të Forta (BTF), faza 2”.....
	22231
Dekret i Presidentit nr. 401, datë 6.12.2024	Për shpallje ligji.....
	22355
Vendim i Gjykatës Kushtuese nr. 76, datë 29.10.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. (11-2013-661) 350, datë 7.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 204/10-2015-506, datë 4.3.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2023-3019, datë 13.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.....
	22355
Vendim i Gjykatës Kushtuese nr. 77, datë 5.11.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 1209/3, datë 19.11.2014, të Komisionit të Disiplinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; nr. 1491, datë 23.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1213 (1197), datë 23.3.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-33, datë 11.1.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.....
	22363

**LIGJ**
Nr. 114/2024**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRI I SHTETIT PËR PUSHTETIN
VENDOR, DHE QEVERISË SË
KONFEDERATËS ZVICERANE,
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM, QË VEPRON PËRMES
AMBASADËS SË ZVICRËS NË
SHQIPËRI, PËR PROJEKTIN “BASHKI
TË FORTA (BTF), FAZA 2”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1,
të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të
Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar
nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe
qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar
nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim, që vepron përmes Ambasadës së
Zvicrës në Shqipëri, për projektin “Bashki të forta
(BTF), faza 2”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij
ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren
Zyrtare.

Miratuar në datën 14.11.2024.

Shpallur me dekretin nr. 401, datë 6.12.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI I SHTETIT
PËR PUSHTETIN VENDOR DHE
QEVERISË SË KONFEDERATËS
ZVICERANE TË PËRFAQËSUAR NGA
AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM
DHE BASHKËPUNIM (NË VIJIM E
REFERUAR SI “SDC-ja”) QË VEPRON
NËPËRMJET AMBASADËS SË ZVICRËS NË
SHQIPËRI PËR PROJEKTIN BASHKI TË
FORTA (BTF), FAZA 2
për
Projektin “Bashki të forta II”

Në përpjekje për të forcuar marrëdhëniet
miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve,

Në përputhje me dhe në zbatim të Marrëveshjes
Kuangari për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe
Humanitar ndërmjet Këshillit Federal të Zvicrës dhe
Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë,
të nënshkruar më 11 maj 2007,

Në respekt të parimeve demokratike dhe të
drejtave themelore të njeriut – siç përcaktohet në
veçanti në Deklaratën Universale të të Drejtave të
Njeriut, e cila frymëzon politikat e brendshme dhe
të jashtme të dyja Palëve dhe përbën një element
thelbësor në të njëjtin nivel me objektivat e kësaj
Marrëveshjeje,

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
(në vijim e referuar si “SDC-ja”) kanë rënë dakord
për termat dhe kushtet e përcaktuar më poshtë.

Neni I**Kushtet dhe përkufizimet e përgjithshme**

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç
rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat vijues
kanë kuptimin e mëposhtëm:

a) “Palët Kontraktuese” nënkupton ministrin e
Shtetit për Pushtetin Vendor të Republikës së
Shqipërisë (përfaqësuar nga ministri) dhe
Konfederatën Zvicerane;

b) “Konfederata Zvicerane” përfaqësohet nga
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
(SDC-ja) e Departamentit Federal të Punëve të
Jashtme të Zvicrës;



c) “SDC-ja” nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Zvicrës, e cila përfaqësohet në Shqipëri nga Ambasada e Zvicrës;

d) “SIDA” nënkupton Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim, e cila është bashkëdonator i interesuar i Projektit;

e) “Projekti” nënkupton projektin “Bashki të forta Shqipëri” financuar nga SDC-ja dhe SIDA;

f) “Organizatë zbatuese” nënkupton Helvetas Swiss Intercooperation (HSI);

g) “SASPAC” nënkupton Agjencinë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës;

h) “Autoritete tatimore” nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Neni II

Përgjegjësia e zbatimit

a) Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor është institucioni kryesor shtetëror përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes dhe realizimin e projektit.

b) SDC-ja është një autoritet ekzekutiv për zbatimin e Marrëveshjes dhe vënien në zbatim të Projektit. SDC-ja ia delegon përgjegjësinë e zbatimit Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

c) SDC-ja ia beson zbatimin e Projektit, Helvetas Swiss Intercooperation.

SIDA është bashkëdonator i Projektit. Në bazë të një marrëveshjeje të veçantë midis SDC-së dhe SIDA-s, SDC-ja do të marrë rolin e donatorit lider në Projekt. SDC-ja do të administrojë kontributet (e SDC-së dhe SIDA-s) dhe do të ndjekë Projektin në raport me Qeverinë Shqiptare dhe me Agjencinë Zbatuese.

Neni III

Qëllimet dhe objektivat

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Projekti është: qytetarët në Shqipëri përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve në nivel bashkie, sipas standardeve minimale dhe të përballueshme financiarisht të dakordësuara për një sistem kombëtar të qëndrueshëm.

Objektivat kryesorë të Projektit, janë:

1. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike drejt standardeve të përballueshme financiarisht.

2. Mbikëqyrja në mënyrën e duhur nga këshillat bashkiakë të performancës së administratës bashkiake dhe angazhimi në vendimmarrje të bazuara në të dhëna.

3. Krijimi i një sistemi të ri të menaxhimit të performancës bashkiake dhe bërja funksional i një mekanizmi granti të bazuar në performancë.

Për të arritur këta objektiva, Projekti do të bashkëpunojë me institucionet e mëposhtme:

1. Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Departamentin e Administratës Publike.

2. 61 Bashki në Shqipëri, shoqatat e qeverisjes vendore;

3. Agjencitë dhe drejtoritë rajonale të dekoncentruara;

4. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Linjat kryesore të ndërhyrjeve dhe rezultatet e parashikuara janë përmbledhur në përmbledhjen e Projektit sipas shtojcës 1.

Neni IV

Fusha e veprimit të Marrëveshjes

Marrëveshja mbulon veprimtaritë e përcaktuara në përmbledhjen e Projektit, e cila i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje (shtojca 1).

Neni V

Përgjegjësitë e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor

a) Mbështet dhe lehtëson lidhjen dhe bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera në nivel qendror dhe rajonal, duke përfshirë institucionet e prefekturave të qarqeve;

b) Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor në bashkëpunim me Ministrinë e Financave alokojnë ekuivalentin e vlerës prej 2’834’000 milionë frangash zvicerane (dy milionë e tetëqind e tridhjetë e katër mijë) për fondin e Grantit të Performancës ose çdo vlerë tjetër si kundërbalancë të kontributeve të Zvicrës dhe Suedisë;

c) Bashkëfinancimi prej së paku 50% për Grantin e Performancës për bashkitë më të mira fituese, planifikohet nga Ministria e Financave në



bashkëpunim me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor.

d) Në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran “Për bashkëpunimin teknik, financiar dhe humanitar”, të ratifikuar me ligjin nr. 9801, datë 13.9.2007, fondet e financuara në kuadër të këtij Projekti nuk do të përdoren për të paguar tatimin mbi vlerën e shtuar.

e) Nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore mundëson alokimin e nevojshëm buxhetor për rimbursimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) në zbatim të fazës së dytë të Projektit “Bashki të forta” për të gjithë periudhën nga fillimi i Projektit, për një shumë maksimale prej CHF 1’000’000 (një milion frangash zvicerane).

f) U mundëson ekspertëve të huaj, të përfshirë në Projekt, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, dhe familjeve të tyre, falas lejet e nevojshme të punës dhe qëndrimit, si dhe përjashtimet nga taksat, të gjitha detyrimet e tjera fiskale dhe detyrimet doganore, për importin e përkohshëm dhe rieksportin e sendeve personale.

Neni VI

Përgjegjësitë e SDC-së

a) Kontributi zviceran është një grant i parimbursueshëm dhe do të përdoret ekskluzivisht për zbatimin e veprimtarive të Projektit, siç përcaktohet në shtojcën 1 “Përmbledhja e Projektit”, e cila përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

b) Fondi total zviceran i grantit për fazën 2 të Projektit arrin deri në 10.755.000 CHF (dhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë franga zvicerane) nga të cilat 2.000.000 CHF (dy milionë franga zvicerane) i dedikohen Fondit të Grantit për Mekanizmin e Performancës (në vijim i referuar si “Fondi për Grantin e Performancës”), i cili do të krijohet nga palët pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

c) Përveç kontributit zviceran, SIDA synon të kontribuojë me CHF 1’170’000 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë franga zvicerane) (nëpërmjet Konfederatës Zvicerane), nga të cilat, CHF 834’000 (tetëqind e tridhjetë e katër mijë franga zvicerane) rezervohen si kontribut në Fondin e Grantit për Performancën.

d) Kontributi i SDC-së dhe SIDA-s nuk do të tejkalojë kontributin e qeverisë shqiptare në fondin e Grantit për Mekanizmin e Performancës. Kontributi zviceran për fondin e Grantit për Performancën do të transferohet vetëm pasi Qeveria Shqiptare të ketë angazhuar të paktën të njëjtën shumë si kontributet zvicerane dhe suedeze dhe kur SDC-ja do të vlerësojë se sistemi publik i duhur do të jetë ndërtuar.

e) Kontributet për Grantin nuk mund të alokohen për ndonjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e pashfrytëzuar e kontributit të grantit, e mbetur në fund të Projektit, i nënshtrohet rimbursimit të SDC-së.

f) SDC-ja do të kontraktojë Helvetas Swiss Intercooperation si agjenci zbatuese.

g) Të gjitha kontributet zvicerane dhe suedeze pjesë e kësaj Marrëveshjeje (me përjashtim të kontributeve që janë rezervuar për t’iu transferuar Grantit për Mekanizmin e Performancës, do të disbursohen dhe auditohen sipas dispozitave të kontratës me Helvetas Swiss Intercooperation.

Neni VII

Menaxhimi i Projektit

Projekti është një sipërmarrje e përbashkët ndërmjet ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave, dhe SDC-së dhe SIDA-s nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

Nga ana e Shqipërisë, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor:

- Është bashkëpërgjegjës për bashkëkryesimin e takimeve të Komitetit Drejtues të Projektit;

- I delegon detyra dhe përgjegjësi për zbatim Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;

- Ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e veprimtarive të dakordësuara të Projektit;

- Ofron kapacitete dhe burime njerëzore të dedikuara për të asistuar partnerin zbatues për pjesë të ndryshme të Projektit, veçanërisht për hartimin ligjor dhe ndihmën për propozime për përshtatjen e kuadrit ligjor për qeverisjen vendore;

- Ofron qasje në informacionin përkatës, duke përfshirë të dhëna statistikore që çmohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit. Informacioni do të përdoret



vetëm për qëllimet e Projektit. Çdo përdorim tjetër do të paraqitet me pëlqimin paraprak me shkrim të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor;

- Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor në bashkëpunim me Ministrinë e Financave vë në dispozicion shumën e barasvlershme deri në 2.834 milionë (dy milionë e tetëqind e tridhjetë e katër) franga zvicerane për fondin e Grantit për Performancën ose çdo shumë tjetër mbi të cilën do të kundërbalancohet kontributi i Qeverisë Zvicerane;

- Bashkëfinancimi me jo më pak se 50% të fondit për bashkitë që performojnë më mirë, planifikohet nga Ministria e Financave në bashkëpunim me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor;

- Lehtëson bashkërendimin me aktorët vendorë në krijimin e një mekanizmi për ngritjen e kapaciteteve për trajnimin dhe menaxhimin e njohurive për administratën vendore dhe përfaqësuesit e zgjedhur vendorë;

- Siguron harmonizimin dhe bashkërendimin e mbështetjes së zhvillimit të ofruar nëpërmjet BtF/SDC-së dhe mbështetjes së donatorëve të tjerë (duke shmangur mbivendosjen);

- Lehtëson procesin me ministritë e linjës (Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit) për caktimin e standardeve të shërbimit;

- Siguron kushte normative për Grantin e Performancës dhe ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve për qeverisjen vendore, duke lehtësuar diskutimin dhe vendimmarrjen (përfshirë aktet normative) për një model të qëndrueshëm financiar të ngritjes së kapaciteteve në nivel vendor, veçanërisht për përfaqësuesit e zgjedhur vendorë.

Nga ana e Zvicrës, SDC-ja:

- Është përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm të Projektit;

- I ka dhënë mandatin për zbatimin e kësaj faze të Projektit Helvetas Swiss Intercooperation në bazë të tenderit ndërkombëtar në vitin 2017;

- Mund të mandatojë ekspertë të huaj dhe vendës afatgjatë dhe afatshkurtër për të mbështetur zbatimin e Projektit;

- Mund të mandatojë individë të tjerë dhe organizata vendëse ose ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve specifike të Projektit.

Neni VIII

Mbikëqyrja dhe bashkërendimi

Për të garantuar mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e Projektit dhe për të trajtuar çështjet e politikave, do të krijohet një Komitet Drejtues, i cili mblidhet dy herë në vit.

Komiteti Drejtues përbëhet nga këta anëtarë me të drejtë vote:

1. 1 përfaqësues nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor (bashkëkryetar);
2. 1 përfaqësues nga Ambasada Zvicerane (bashkëkryetar);
3. 1 përfaqësues nga SIDA;
4. 1 përfaqësues nga Ministria e Financave;
5. 1 përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
6. 1 përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
7. 1 përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV);
8. 1 përfaqësues nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA);
9. 1 përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike;
10. 1 përfaqësues (kryetari/kryetarët) nga shoqata/t e qeverisjes vendore;
11. 9 përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Përzgjedhja e tyre, do të:

- jetë me rotacion për çdo takim të komitet drejtues. Përzgjedhja e tyre do të bazohet në temat e diskutimit për çdo takim të komitetit drejtues;

- balancojë përfaqësimin e legjislativit me ekzekutivin;

- përfshijë Bashkinë e Tiranës si anëtare të përhershme;

- balancojë në mënyrë proporcionale partitë politike.

Anëtarët e mëposhtëm kanë statusin e vëzhguesit në Komitetin Drejtues:

1. 1 përfaqësues nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC);

2. 2 përfaqësues nga institucioni i Prefektit (me rotacion);

3. 1 përfaqësues nga shoqata e qarqeve;

4. 1 përfaqësues nga njësitë rajonale të decentralizuara;

5. menaxher projekti nga FSO/SALSTAT;



6. 1 përfaqësues nga SECO/FL-ja;
 7. përfaqësues nga donatorë të tjerë të interesuar.
- Vëzhguesit nuk kanë të drejtë vote.

Në varësi të nevojës dhe agjendës së diskutimit, palë të tjera interesi mund të ftohen të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesve nga bashkëkryesuesit e Komitetit Drejtues.

Komiteti Drejtues kryen këto detyra:

1. Siguron që zbatimi i Projektit të jetë në përputhje me qëllimet kryesore, objektivat dhe rezultatet e pritshme, të përcaktuar në dokumentin e Projektit;

2. Miraton planet vjetore të Projektit për veprimtaritë, buxhetet dhe raportet vjetore;

3. Siguron që zbatimi i Projektit të kontribuojë në dialogun e politikave për decentralizimin dhe qeverisjen vendore në vend;

4. Siguron ofrimin dhe shkëmbimin e informacionit mbi zhvillimet përkatëse kombëtare dhe marrëdhëniet me palët e interesit në nivel kombëtar;

5. Angazhohet për qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve të Projektit.

Takimet e paplanifikuara mund të shpallen me kërkesë të anëtarëve të Komitetit Drejtues.

Takimet mbahen në prani të bashkëkryesuesve të Komitetit Drejtues.

Sekretariati i Komitetit Drejtues sigurohet nga ekipi i Projektit.

Neni IX

Raportimi dhe informimi

Raportet e progresit do të përgatiten nga organizatat zbatuese çdo 6 muaj.

Palët Kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën dhe në masën që është praktikisht e arsyeshme, do të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me çdo ngjarje, e cila pengon ose rrezikon të pengojë zbatimin e suksesshëm të Projektit.

Neni X

Monitorimi dhe vlerësimi

SDC-ja do të mbikëqyrë zbatimin e Projektit.

Një ushtrim i rishikimit të jashtëm, është planifikuar të zhvillohet në vitin 2025.

Neni XI

Prokurimi

Organizatat zbatuese janë përgjegjëse për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për zbatimin e Projektit, duke zbatuar parimet e konkurrencës së drejtë (të lirë dhe të barabartë) ndërmjet ofertuesve potencialë për të arritur efikasitet në përdorimin e fondeve publike.

Organizatat zbatuese do të zbatojnë ligjin zviceran të prokurimit.

Neni XII

Mallrat

a) Për kohëzgjatjen e Projektit, mallrat e siguruar me fondet e SDC-së për përdorim në Projekt do të mbeten në dispozicion të pakufizuar të Projektit dhe nuk do të devijohen nga Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

b) Nëse për ndonjë arsye Projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të ofruara me kontributin zviceran dhe suedez do të vendoset me shkrim nga Palët. Në një rast të tillë, SDC-ja nuk do të marrë asnjë përgjegjësi në lidhje me mallrat në fjalë.

c) Në fund të Projektit, SDC-ja do të vendosë në lidhje me pronën dhe përdorimin e mallrave të prokuruar me fondet e Projektit.

d) Mallrat e prokuruar nga Projekti për organizatat partnere, do t'i dorëzohen dhe do të merren nga autoriteti kompetent përkatës me miratimin e SDC-së.

Neni XIII

Përfundimi i Marrëveshjes

a) Secila Palë kontraktuale do të ketë të drejtën ta përfundojë këtë Marrëveshje duke dhënë njoftim me shkrim për përfundimin e saj gjashtë muaj para.

b) Nëse njëra Palë kontraktuale çmon se qëllimet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të arrihen më ose se Pala e dytë nuk po përmbush detyrimet e saj, Pala tjetër do të ketë të drejtë ta pezullojë ose përfundojë këtë Marrëveshje, duke dhënë njoftim me shkrim tre muaj para. Pavarësisht nga sa më sipër, secila palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje me efekt të menjëhershëm në rast të shkeljes thelbësore të Marrëveshjes. Shkelje thelbësore nënkupton shkelje



të rëndë të një prej objektivave kryesorë të kësaj Marrëveshjeje.

c) Nëse ngjarjet që shkaktohen nga forca madhore (fatkeqësi natyrore etj.) pengojnë ekzekutimin e Marrëveshjes, secila Palë kontraktuale mund ta ndërpresë Marrëveshjen me efekt që nga momenti kur zbatimi i saj bëhet i pamundur.

d) Në rast të përfundimit të parakohshëm të kësaj Marrëveshjeje ose në përfundim të Projektit, çdo fond i pashpenzuar, i siguruar në kuadër të Projektit, do t'i kthehet SDC-së.

Neni XIV

Ndryshimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim ose ndryshim i kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me pëlqimin e të dyja Palëve.

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen me bisedime diplomatike ndërmjet Palëve.

Neni XV

Dispozitat e përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët nuk do të propozojnë as drejtpërdrejt, as në mënyrë të tërthortë përfitime të çfarëdo natyre. Ato nuk do të pranojnë asnjë propozim të tillë. Çdo sjellje korruptuese ose e paligjshme nënkupton një shkelje thelbësore të kësaj Marrëveshjeje dhe përligj përfundimin e saj, si dhe/ose rekursin ndaj masave korrigjuese plotësuese në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni XVI

Shtojcat

Përmbledhja e Projektit (shtojca 1) përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Neni XVII

Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje mbulon fazën e dytë të projektit deri më 30.9.2026.

Ajo hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dyja palët dhe përfundimin e procedurës së brendshme ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Kjo Marrëveshje është hartuar në dy kopje origjinale, në gjuhët angleze dhe shqipe. Në rast diferencash në interpretim, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Palët konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje, të hartuar në Tiranë, më2024.

Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë:
Arbjan Mazniku
Ministër
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Në emër të Konfederatës Zvicerane:
Ruth Huber
Ambasadore
Ambasada e Zvicrës

SHTOJCA 1

PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT – SHQIPËRIA: BASHKI TË FORTA (BtF), FAZA 2, 2022–2026

**Zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation
Kontributi Financiar Zviceran Suedez – Granti
11'925'000 franga zvicerane**

Analiza e kontekstit

Që nga viti 2015, viti i fillimit të Reformës Administrative Territoriale, është bërë progres i rëndësishëm drejt forcimit të qeverisjes vendore (QV) në Shqipëri¹. Nga vlerësimi i zbatimit të Strategjisë për Decentralizim 2015–2022, rezultuan se rreth 75% e masave të planifikuara janë realizuar². Performanca e menaxhimit kryesor fiskal dhe financiar të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri ka qenë pozitive, me përmirësim të dukshëm krahasuar me periudhën para strategjisë: rreth 80% e bashkive kanë pasur rritje të të ardhurave vendore, duke konsoliduar kështu kapacitetin e tyre fiskal për të financuar shërbimet vendore. Megjithatë, një ofrim i plotë i shërbimeve do të kërkonte burime financiare shtesë, veçanërisht për investime në infrastrukturë. Funksionet e veta të bashkisë (si ato

¹ Raporti i Monitorimit i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore nga Kongresi i Autoriteteve Vendore, KiE 2021.
Faqe | 22336

² Projektstrategjia për Decentralizim 2023–2030, versioni janar 2023.



historike ashtu edhe ato të sapodeleguara pas reformës territoriale) kanë shënuar përmirësime. Për shembull, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve në impiantet e trajtimit është përmirësuar ndjeshëm; numri i kopshteve dhe i mësuesve është rritur përkatësisht me 14% dhe me 10% që nga viti 2015. Janë vendosur standardet për ofrimin e shërbimeve dhe është sqaruar roli i bashkive në planifikimin, buxhetimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Bashkitë kanë përmirësuar ndjeshëm komunikimin e tyre me qytetarët dhe informojnë në mënyrë proaktive mbi vendimmarrjet e qeverisjes vendore. Çdo bashki ka krijuar faqen e saj të internetit ku publikohen vendimet e këshillit bashkiak. Janë ndërmarrë hapa konkretë drejt garantimit të transparencës së mbledhjeve të këshillit bashkiak, duke i transmetuar ato drejtpërdrejt, si dhe duke shfrytëzuar regjistrat elektronikë të konsultimit dhe përpunimit të kërkesave (fizikë dhe *online*).

Megjithatë, duke pasur parasysh se 70% e *Acquis Communautaire* do të zbatohet në nivel vendor, bashkitë ende duhet të përmirësojnë modalitetet e tyre të punës dhe të matin performancën e tyre bazuar në të dhëna. Mbeten ende mangësi në ofrimin e shërbimeve të bazuara në standarde, menaxhimin efektiv të financave publike, si dhe në proceset demokratike. Një sistem i ngritjes së kapaciteteve për bashkitë (administrata dhe këshillat bashkiakë) do të përmirësonte efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e mbështetje kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel vendor.

Qeveria Shqiptare (QSH) u angazhua në një proces digjitalizimi duke përmirësuar qasjen në ofrimin e shërbimeve kombëtare. Megjithatë, shërbimet publike vendore janë lënë pas, duke përdorur ende sisteme të tjera gjysmë të automatizuara (p.sh. zyrat me një ndalesë). Integrimi i regjistrave të ndryshëm në nivel qendror dhe vendor, si dhe njohuritë digjitale, qasja në zona të largëta dhe mbrojtja e të dhënave mbeten sfiduese. Për sa i përket përfaqësimit, sistemi zgjedhor me lista partiake të mbyllura për këshillat bashkiakë dhe përbërja aktuale monopartiake e tyre pengon përfaqësimin politik pavarësisht përmirësimit në aspektin gjinor me 43% të këshilltareve bashkiakë gra. Zgjedhjet vendore të vitit 2023 e përmirësuan këtë situatë.

Qeveria Shqiptare ka përgatitur një strategji të re decentralizimi 2023–2030. Kjo ka sjellë një mundësi për të përmirësuar shërbimet, transparencën e transfertave financiare, si edhe përcaktimin më të mirë të përgjegjësiive ndërmjet niveleve. Strategjia e re e decentralizimit *synon konsolidimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik vendor me shërbime cilësore, përfshirje të qytetarëve dhe transparente ndaj standardeve evropiane*, si edhe vendosjen e standardeve dhe matjen e performancës për krijimin e një mekanizmi transparent të transferimit të burimeve financiare.

Përfituesit dhe grupet e synuara

Projekti *synon t'i shërbejë të gjithë popullsisë së Shqipërisë (2,8 milionë banorë) në të 61 bashkitë*. Ky mbulim dhe mbështetje kombëtare për të gjitha bashkitë (dhe jo vetëm për ato të përzgjedhura) është një hap i rëndësishëm për zgjerimin e fushës së veprimit të Projektit. Projekti do të fokusohet te 61 administrata bashkiake, të gjithë 1.650 këshilltarët bashkiakë (43% F), stafi i zyrave rajonale të statistikave dhe ministritë e linjës. Shoqatat e qeverisjes vendore do të jenë partnerë të ngushtë në zbatimin e Projektit.

Rezultatet kryesore dhe mësimet e nxjerra nga faza 1 e BtF-së

Një numër rezultatesh të rëndësishme janë arritur gjatë fazës së parë: i) BtF-ja realizoi ambicien për të vendosur linjë komunikimi me të gjitha 61 NJVV-të e reja; ii) Menaxhimi i mbetjeve u përmirësua në 18 bashki dhe në nivel kombëtar, zona e mbuluar me shërbimin e mbetjeve u rrit në 75% (2021) nga 63.1% në vitin 2018. Përmirësimi i tarifës së grumbullimit, e cila u rrit me 31% krahasuar me vitin 2018 dhe strategji më të mira të faturimit për shërbimin, ka çuar në një performancë më të mirë financiare të NJVV-ve; iii) Udhëzuesi për menaxhimin e arsimit parashkollor është miratuar nga QSH-ja në shkurt 2020. 6 bashki kanë alokuar më shumë buxhet për këtë shërbim bazuar në planet e përmirësimit të shërbimit. Të 61 bashkitë po zbatojnë të paktën një aspekt të udhëzimit³; iv) 36 bashki janë mbështetur për të përgatitur raporte të performancës bazuar në treguesit e matur dhe në procesin buxhetor afatmesëm. 16 prej tyre u ndihmuan drejtpërdrejt për të përgatitur raporte ndërvepruese, të cilat u diskutuan me këshillat

³ Planifikimi i strukturës së stafit në përputhje me numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte.



bashkiakë dhe qytetarët në seancat e transmetimit të drejtpërdrejtë; v) Rregullat dhe procedurat për këshillat bashkiakë, komisionet dhe sekretaritë e këshillit bashkiak u vendosën për herë të parë në Shqipëri. Transparenca në vendimarrje të këshillave bashkiakë u përmirësua përmes transmetimit të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të tyre.

Janë nxjerrë mësimet të rëndësishme: i) Krijimi i sistemeve dhe i procedurave të qëndrueshme për të përmirësuar shërbimet publike, është një proces afatgjatë; ii) Përqendrimi në ngritjen e një sistemi të monitorimit të performancës bashkiake ka potencial për të përmirësuar qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve sepse mundëson një diskutim të informuar me qytetarët. Ai, gjithashtu, mbështet detyrën mbikëqyrëse të këshillave ndaj administratës bashkiake përmes një dialogu të bazuar në të dhëna të besueshme; iii) Mbështetja për bashkitë duhet të jetë e përshtatur, bazuar në nivelin e tyre të interesit dhe angazhimit; iv) Duhet të forcohet menaxhimi i njohurive nëpërmjet shkëmbimeve të kolegëve ose trajnimit/asistimit; v) Mbështetja e këshillave bashkiakë është një strategji e vlefshme për të forcuar ndarjen e pushteteve. Pas zgjedhjeve të vitit 2023 dhe zëvendësimit relativ të prishëm të këshilltarëve dhe kryetarëve të bashkive, një angazhim i rëndësishëm i projektit do të fokusohet në këtë drejtim; vi) Transmetimi dhe komunikimi i shtuar i këshillave bashkiakë me publikun çon në përmirësimin e angazhimit të qytetarëve; vii) Këshillat bashkiakë janë një pikë hyrëse e mirë për të punuar në drejtim të fuqizimit politik të grave; viii) Digjitalizimi i shërbimeve dhe këshillave bashkiakë çon në një qeverisje të përmirësuar; ix) Pikat Fokale Rajonale që mbulojnë të 12 qarqet në Shqipëri u treguan efektive për të arritur të gjitha NJVV-të; x) Lidhja e të dhënave me mbështetjen e qeverisjes vendore është thelbësore për të marrë vendime të informuara dhe monitoruar ofrimin e shërbimit; xi) Qeverisja e Projektit do të përshtatet, duke ndarë mandatin e Helvetas Swiss Intercooperation dhe mbështetjen për statistikat vendore (SALSTAT-i), një kontribut i drejtpërdrejtë për INSTAT-in.

Qëndrueshmëria e Projektit, vizioni përfundimtar, strategjia e daljes

Faza 2 është një fazë konsolidimi që synon të mbështetet në rezultatet e fazës së parë. Qëndrueshmëria e BtF 2 do të mbështetet në punën me aktorët e sistemit që nga fillimi i çdo ndërhyrjeje, duke mbështetur hartimin e kuadrit ligjor (duke

përfshirë rregullat dhe procedurat) dhe mekanizmat financiarë në nivel kombëtar. BtF 2 do të përpiket që ndërhyrjet e saj të financohen gjithnjë e më shumë nga institucionet shqiptare.

Vlerësimi i palëve të interesit

Partneri kryesor kombëtar për reformat globale të decentralizimit është **Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor**, si autoriteti publik përgjegjës për decentralizimin, e cila tregon udhëheqësi në agjendën e decentralizimit. **Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)** është dora operative e Ministrisë. Aktualisht po mbështet kryesisht dialogun ndërmjet QV-së dhe ministrive. Agjencia ka marrë një rol aktiv dhe një përgjegjësi të re në hartimin e SKD-së së re 2023–2030. **Ministria e Financave (MF)** është shumë e interesuar të angazhohet për krijimin e një mekanizmi financiar të bazuar në performancë. BtF 1 ka asistuar MFE-në për të përgatitur një Raport Kombëtar të Përputhshmërisë së Monitorimit të Buxhetit, i cili është një bazë e fortë për krahasime ndërmjet bashkive dhe për një mekanizëm të performancës. Partneritetet me **Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit** do të jenë sektoriale dhe të fokusuara në vendosjen dhe monitorimin e standardeve për menaxhimin e mbetjeve dhe edukimin në fëmijërinë e hershme nga bashkitë. **INSTAT-i** është partneri kryesor dhe i vetëm për prodhimin e të dhënave dhe statistikave. Ai është institucion i pavarur, efikas dhe aktualisht po forcon praninë e tij në nivel bashkiak. Është krijuar një bashkërendim i ngushtë me INSTAT-in për ngritjen e kapaciteteve të njësive të performancës pranë bashkive. Shoqatat e Qeverisjes Vendore aktualisht po tregojnë një interes të madh për monitorimin e performancës. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike mund të bëhet një partner i rëndësishëm sistemik për BtF 2 për bashkëhartimin, bashkëzbatimin dhe në fund dorëzimin e paketave të trajnimit. **Bashkitë, administrata dhe këshillat bashkiakë** janë partnerët kryesorë në zbatimin e Projektit. Zgjedhjet vendore të vitit 2023 mund të sjellin ndryshime në udhëheqjen aktuale politike të NJVV-ve, si dhe ndryshime në anëtarësinë e këshillave bashkiakë.

Objektivat e Projektit

Qëllimi i përgjithshëm i Projektit është: *qytetarët në Shqipëri përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes dhe i ofrimit të shërbimeve në nivel bashkie, sipas standardeve minimale dhe*



të përballueshme të dakordësuara për një sistem të qëndrueshëm në nivel vendi.

Projekti do të sjellë tri rezultate:

Rezultati 1: Administratat bashkiake përmirësojnë ofrimin e shërbimeve (menaxhimi i mbetjeve dhe arsimit parashkollor) drejt standardeve të përballueshme. Projekti do të mbështesë një administratë bashkiake me performancë të mirë dhe të përqendruar te qytetarët, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve duke vendosur standarde dhe duke mobilizuar burime financiare për shërbimet;

Rezultati 2: Këshillat bashkiakë mbikëqyrin në mënyrën e duhur performancën e administratës bashkiake dhe angazhohen në vendimarrje të bazuara në të dhëna. Projekti do të mbështesë këshillat bashkiakë për të vendosur rregulla dhe rregullore, si dhe mekanizma transparente dhe gjithëpërfshirës të komunikimit me qytetarët;

Rezultati 3: Ekziston një sistem i ri i menaxhimit të performancës bashkiake dhe një mekanizëm granti i bazuar në performancë. Projekti do të synojë përgatitjen e një mekanizmi kombëtar të menaxhimit të performancës që do të monitorojë arritjen e standardeve të qeverisjes dhe të ofrimit të shërbimeve nga bashkitë. Një skemë granti e bazuar në performancë do të nxisë bashkitë për të arritur standardet e shërbimit dhe qeverisjes.

Projekti mbështetet në teorinë e mëposhtme të ndryshimit: **nëse** bashkitë (ekzekutivi dhe legjislativi) janë të përgjegjshme, të afta, transparente dhe **nëse** kuadri ligjor i qeverisjes së mirë dhe i ofrimit të shërbimeve përmirësohet duke përdorur mirë të dhënat, standardet dhe digjitalizimin, **atëherë** këshillat vendore, qeverisja demokratike dhe ofrimi i shërbimeve do të përmirësohen, **sepse** institucionet llogaridhënëse janë thelbësore për demokracinë pluraliste dhe për të ofruar shërbime për qytetarët.

Temat transversale

Çështjet gjinore dhe përfshirja sociale do të mbetet një temë shumë e rëndësishme transversale. Duke iu përgjigjur nevojave të më të varfërve, Projekti do të përfshijë këshillat bashkiakë në politika pro të varfëve dhe administratën për pjesëmarrje më transparente dhe qytetare. Çështja gjinore do të përfshihet në buxhete, veprimtari dhe gjenerim të të dhënave për performancën e bashkive dhe sistemin e M&V, aty ku është e mundshme. Komisionet e Çështjeve Gjinore dhe të Përfshirjes Sociale në këshillat bashkiakë do të jenë mundësuesit kryesorë. BtF-ja

do të zbusë rrezikun e “përrjashtimit digjital”, duke kombinuar mjetet elektronike me veprimtaritë bpb për të siguruar shtrirjen e duhur. Ndërgjegjësimi mjedisor dhe përgjegjësia publike do të përfshihen në partneritet me bashkitë.

Strategjia e ndërhyrjes

Ndërhyrja mbështet **ndarjen e pushteteve në nivel bashkiak**, duke forcuar administratën dhe këshillat bashkiakë.

Përmirësimi dhe digjitalizimi i të dhënave do të krijojë bazën për procese dhe mbikëqyrje vendimesh më të informuara dhe transparente, duke përfshirë edhe nga qytetarët. Aspektet e mbrojtjes dhe besueshmërisë së të dhënave mbeten në qendër të vëmendjes në kuadër të kësaj ndërhyrjeje. Statistikat e besueshme dhe të decentralizuara do të jenë një element kyç për ngritjen e një skeme GBP që do të kontribuojë në zbatimin e Reformës së Administratës Publike. Ky komponent i Projektit zhvillohet nëpërmjet një kontributi të drejtpërdrejtë për INSTAT-in dhe nëpërmjet ekspertizës teknike të ofruar nga ZFS-ja për zbatimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Statistikave 2022–2024 (kapitujt e statistikave vendore dhe rajonale).

Mbështetja e drejtpërdrejtë për NJVV-të do të jetë e personalizuar dhe e bazuar në kërkesë. Një “meny” që përfshin mundësitë e mbështetjes nga Projekti do të dakordësohet me bashkitë gjithashtu duke marrë parasysh nivelin e tyre të angazhimit konkret. BtF-ja do të bashkëhartojë dhe ankorojë asistencën teknike sa më shumë që të jetë e mundshme në institucione dhe organizata që kanë një rol sistemik në ngritjen e kapaciteteve të bashkive (shoqatat e qeverisjes vendore, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike). Do të mbështetet një sistem i shkëmbimeve mes kolegëve dhe trajnimit/asistimit.

Lidhur me ngritjen e një **skeme Granti të Bazuar në Performancë**, Projekti do të angazhojë dhe mbështesë ministritë përgjegjëse (MF-ja, MSHPV-ja) në hartimin dhe ngritjen e mekanizmit (afërsisht 2 vjet) dhe do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor. Megjithatë, **kontributi financiar i SDC-së do të jepet vetëm nëse dhe kur: a) mekanizmi financiar kombëtar do të krijohet plotësisht nga Qeveria Shqiptare; dhe b) do të jepet kontributi (burimet e brendshme). Kontributi i SDC-së nuk do të shkojë përtej 50%**



të grantit (përfshirë kontributin e donatorëve) dhe nuk do të jetë më i madh se kontributi i Qeverisë Shqiptare. Objektivi është nxitja e donatorëve të tjerë potencialisht të interesuar për t'iu bashkuar skemës së granteve (Suedia, BB-ja, BE-ja), duke shmangur strukturat paralele. Ambasada Zvicerane do të angazhohet fuqishëm në një dialog politik duke nxitur bashkërendimin ndërmjet ministrive të përfshira (MSHPV-ja, MF-ja) dhe me donatorët e interesuar. BtF-ja, gjithashtu, do të angazhohet në nivel teknik për të nxitur projekte të tjera të financuara nga donatorët për të kontribuar në sistemin në nivel vendi në vend të krijimit të mekanizmit paralel për dhënie e granteve bashkiake. Do të ngrihet një sistem i mirë dhe i shëndoshë monitorimi për vlerësimin nga afër të

zbatimit të Projektit dhe si një mekanizëm llogaridhënieje.

Angazhimi i Ambasadës Zvicerane në bashkëdrejtimin e Grupit Teknik të Punës për decentralizimin do të vazhdojë, si dhe mbështetja e saj në procese të rëndësishme (Strategjia Kombëtare e Decentralizimit dhe planet e veprimit, RAT-i).

Burimet financiare

Buxheti total arrin në 11'925'000 franga zvicerane. Helvetas Swiss Intercooperation do të menaxhojë mandatin prej rreth 9.084 milionë FZ. Projekti ka zgjeruar fushën e tij të veprimit në mbarë vendin dhe synon të krijojë mekanizmin e **GBP-së me një grant prej 2.834 milionë FZ** (vetëm sipas kushteve të përmendura më lart). Një vlerësim i jashtëm do të bëhet në vitin 2025.

Në FZ

		Faza 2					
	Përshkrimi	2022	2023	2024	2025	2026	Gjithsej
	Rezultatet e Projektit	570'000	2'100'000	2'275'500	2'336'000	1'809'5000	9'091'000
	Granti i bazuar në performancë				1'834'000	1'000'000	2'834'000
	Kredit total	990'000	2'660'000	2'620'000	3'470'000	2'360'000	11'925'000

Monitorimi dhe drejtimi

Referenca kryesore për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të Projektit do të jetë teoria e ndryshimit dhe rezultatet e dakordësuara. Korniza logjike do të jetë një orientim i përgjithshëm për zbatimin e Projektit, por duhet të përshtatet nëse

është e nevojshme. Komitetet drejtuese do të miratojnë planet operative, si dhe raportet e progresit. Rolet dhe përgjegjësitë e hollësishme do të përshkruhen në termat e referencës të Komitetit Drejtues.



Agreement

between

**The Council of Ministers of the Republic of Albania
represented by**

The State Minister on Local Government

and

**The Government of the Swiss Confederation
represented by
the Swiss Agency for Development and Cooperation (herein after referred to as SDC)
acting through the Embassy of Switzerland in Albania**

on

Bashki te Forta II (Strong Municipalities II) Project

Phase 2



In an endeavour to strengthen the friendly relations existing between the two Countries,

In pursuance and in application of the Framework Agreement concerning Technical, Financial and Humanitarian Cooperation between the Swiss Federal Council and the Council of the Ministers of the Republic of Albania, signed on 11th May 2007,

In respect for democratic principles and fundamental human rights – as set out in particular in the Universal Declaration of Human Rights that inspires the internal and external policies of the two Parties and constitutes an essential element on an equal footing with the objectives of the present Agreement,

The State Minister on Local Government and the Swiss Agency for Development and Cooperation (hereinafter referred to as “SDC”) have agreed on the terms and conditions as set forth below.

Article I General Conditions and Definitions

Wherever used in this Agreement, unless the context otherwise requires, the subsequent terms have the following meaning:

- a) "Contracting Parties" means the State Minister on Local Government of the Republic of Albania (represented by the Minister) and the Swiss Confederation;
- b) The “Swiss Confederation” is represented by the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Federal Department of Foreign Affairs;
- c) “SDC” means the Swiss Agency for Development and Cooperation of the Ministry of Foreign Affairs of Switzerland, which is represented in Albania by the Embassy of Switzerland;
- d) “Sida” means the Swedish Development Cooperation Agency which is the interested co-donor of the Project;
- e) The “Project” means the “Bashki të Forta II (Strong Municipalities II) Albania” project financed by SDC and Sida;
- f) “Implementing organisation” means Helvetas Swiss Intercooperation (HSI).
- g) “SASPAC” means the State Agency of Strategic Programming and Aid Coordination
- h) “Tax authorities” means General Directorate of Taxation and General Directorate of Customs.

Article II Implementation Responsibility

- a) The State Minister on Local Government shall be the main responsible state institution for the application of the agreement and the implementation of the Project.



- b) SDC shall be an executive authority for the application of the Agreement and the implementation of the Project. SDC shall delegate the implementation responsibility to the Embassy of Switzerland in Albania.
- c) SDC shall entrust Helvetas Swiss Intercooperation with the implementation of the Project.
- d) Sida is the co-donor of the Project. According to a separate agreement between Sida and SDC, SDC will take on the role of lead donor of the Project. SDC will administer the contributions (of SDC and Sida) and follow-up on the Project towards the Albanian Government and the Implementing Agency.

Article III Goals and Objectives

The overall goal of this Project is: Citizens in Albania benefit from improved governance and service delivery at the municipal level, according to agreed minimum and financially affordable standards for a sustainable country system.

The main objectives of the Project are:

- 1. Municipal administrations improve service delivery (waste management and preschool) towards more appropriate and affordable standards;
- 2. Municipal councils oversee adequately the performance of municipal administration and engage in evidenced based decision-making;
- 3. A new municipal performance management system and a performance-based grant mechanism is in place.

To achieve these objectives, the Project shall cooperate with the following institutions:

- 1. The State Minister on Local Government and the Agency for Support to Local Self-Government; Ministry of Finance; Ministry of Tourism and Environment; Ministry of Energy and Infrastructure; Ministry of Education and Sports; Department of Public Administration;
- 2. 61 Municipalities in Albania, Associations of Local Governments;
- 3. Regional deconcentrated agencies and directorates;
- 4. Albanian School of Public Administration.

The main lines of interventions and envisaged results are summarized in the Project Summary under Annex 1.

Article IV Scope of the Agreement

The Agreement shall cover the activities spelled out in the Project Summary, which is attached to this Agreement (Annex 1).

Article V Responsibilities of the State Minister on Local Government:

- a) Supports and facilitates the link and cooperation with other ministries and institutions at central and regional level, including prefecture's offices;



- b) The State Minister on Local Government in cooperation with the Ministry of Finance shall allocate the equivalent of up to CHF 2'834'000 (two million and eight hundred and thirty-four thousand Swiss Francs) for the Grant Fund for Performance or any other amount on which basis the contribution from Swiss and Swedish government will be counterbalanced;
- c) The co-financing with at least 50% of the Grant Fund for Performance for the best performing municipalities is planned by the Ministry of Finance in cooperation with the State Minister on Local Government;
- d) Pursuant to the Agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania and the Swiss Federal Council "On Technical and Financial Cooperation and Humanitarian Aid ", ratified by law no. 9801, dated 13.09.2007, the funds disbursed within this project will not be used to pay the value added tax.
- e) Through the Agency for the Support of Local Self-Government, enables the necessary budget allocation for the reimbursement of Value Added Tax (VAT) in reference to the Phase 2 of the Bashki te Forta project for the entire period from the start of the project, for a maximum amount of CHF 1'000 '000 (one million Swiss francs).
11. Në këtë këndvështrim, kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shtih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata konstaton se vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit është ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që mban datën 13.7.2023, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 12.2.2024. Me shkresën nr. 6130/1 prot., datë 22.11.2023, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 13.11.2023, që është edhe momenti kur palët mund ta dispononin këtë vendim. Për rrjedhojë, duke konsideruar datën 13.11.2023, si data nga e cila fillon të llogaritet afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata vlerëson se ai është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj prapësimi i subjektit të interesuar, Komunitetit Mysliman, për mungesën e



legjitimit *ratione temporis* të kërkuesve, është i pabazuar.

15. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pretendime të cilat, për nga natyra e tyre, janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Megjithatë, duke pasur parasysh përmbajtjen dhe thelbin e këtyre pretendimeve, Gjykata çmon që t'i vlerësojë ato në drejtim të bazueshmërisë në themel, duke i analizuar të ndërlydhura me njëra-tjetrën.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

16. Kërkuesit kanë pretenduar se edhe pse përpara gjykatave janë ngritur pretendime pronësie, ato e kanë devijuar gjykimin, duke e trajtuar si një çështje për “njohje dhe kthim prone”. Sipas tyre, padia e paraqitur në gjykata është padi rivendikimi, sipas nenit 296 të KC-së, e cila është shoqëruar edhe me kërkimin e shfuqizimit të aktit cenes të së drejtës, ndërkohë që gjykatat kanë ndryshuar shkaku ligjor të saj, duke e trajtuar si padi ndaj AKKP-së për njohje dhe kthim prone sipas ligjit nr. 9235/2004. Kjo, sipas kërkuesve, ka sjellë që pretendimet për të drejtën e pronës të mos merren në shqyrtim, duke mos marrë përgjigje përfundimtare për bazueshmërinë ose jo të tyre. Po sipas kërkuesve, arsytimi i gjykatave është kontradiktor, i paplotë dhe nuk u jep përgjigje pretendimeve të tyre për të drejtën e pronës, ndërkohë që gjykatat nuk kanë vlerësuar provat, ndërsa ekspertit i caktuar nga vetë gjykata ka konfirmuar se në bazë të dokumenteve ka mbivendosje të pronave dhe se të dyja palët në proces janë pronare dhe fqinje. Sipas tyre, gjykatat nuk janë shprehur as për dokumentacionin arkivor të vitit 1932, që konfirmon transaksionin dhe regjistrimin e pronësisë së trashëgimlënësit të kërkuesve, ndërkohë që kanë vlerësuar si provë për pronësinë e Komunitetit Mysliman dekretin nr. 279, datë 7.2.1947, pa marrë parasysh se ky dokument përbën provë edhe për pronësinë e kërkuesve, për sa kohë trashëgimlënësi i tyre A.H. paraqitet si kufitar në veri të truallit të shtetëzuar, Vakëfit Mysliman. Sipas kërkuesve, gjykatat kanë anashkaluar edhe faktin se trashëgimtarët e A.H. e

kanë poseduar dhe vazhdojnë ta posedojnë pronën si përpara, ashtu edhe pas viteve '90, pa ndryshime.

17. Subjekti i interesuar, Komuniteti Mysliman, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë zbatuar drejt ligjin procedural dhe material, duke mos i legjitimuar ata në ngritjen e padisë, për shkak se ata e kanë ezauruar të drejtën për t'iu drejtuar organit kompetent, AKKP-së, i cili, me vendimin nr. 240/2017 ka vendosur të mos u njohë pronësinë, vendim ky që ka marrë formë të prerë dhe nuk është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, duke marrë statusin e “gjësë së gjykuar”. Për rrjedhojë, pranimi i çdo argumenti ndryshe do të cenonte parimin e sigurisë juridike. Sipas këtij subjekti, kërkuesit nuk kanë provuar cenimin e ndonjë të drejte nga palët e paditura në procesin gjyqësor, për aq kohë sa Komuniteti Mysliman është pronar i truallit me vendimin nr. 205/1/1997, të KKKP-së, Durrës. Po sipas këtij subjekti, vendimet gjyqësore janë në përputhje me standardet kushtetuese të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe vendimi i Gjykatës së Lartë ka parashtruar saktë pretendimet e palëve, vendimet e gjykatave më të ulëta dhe pasi Kolegji Civil ka bërë vlerësimin e tij, ka arsyetuar këtë vendimmarrje, ndërkohë rekursi i kërkuesve nuk përmbante shkaqe nga ato që kërkojnë dispozitat ligjore në fuqi.

18. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të



arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, zbatimi i këtij parimi vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes. Ndërsa ka pohuar se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë, Gjykata ka theksuar se kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 7.3.2024; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kurse për sa u përket vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në fazën e shqyrtimit paraprak të rekurseve, Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së keshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 19, datë 19.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuar në ankimin kushtetues individual ka të bëjë, në thelb, me faktin se gjykatat e zakonshme kanë rrëzuar padinë e tyre

të pronësisë pa e shqyrtuar atë themel, pra pa i dhënë përgjigje bazueshmërisë ose jo të pretendimeve të tyre, duke arsyetuar se atyre u mungon interesi i ligjshëm ndaj nuk legjitimohen në ngritjen e saj për sa kohë nuk kanë kundërshtuar gjyqësisht dhe brenda afatit ligjor një vendim të AKKP-së, me të cilin është disponuar për mosnjohjen e së drejtës së pronësisë. Ndaj, për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, Gjykata vlerëson të analizojë nëse interpretimi i gjykatave të zakonshme për mospasjen interes të ligjshëm të kërkuar në ngritjen e padisë përmbush standardet kushtetuese në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Me fjalë të tjera, Gjykata do të verifikojë nëse arsyetimi i gjykatave të zakonshme përmban gabime faktike ose ligjore, të cilat nuk janë objektivist të justifikueshme dhe të arsyeshme.

22. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson të theksojë se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimues, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në legjislacionin procedural, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Në përputhje me këtë, neni 31 i KPC-së e ka përkufizuar padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që ngre pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo në fakte e në ligje, kurse neni 32, shkronja "a", parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur. Sipas nenit 12 të KPC-së, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj. Në këtë kuptim, është pala që vë në lëvizje gjykatën që ka detyrimin të provojë pretendimet e saj dhe të paraqesë provat për këtë qëllim (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 38, datë 30.6.2014; nr. 5, datë 20.3.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Referuar fakteve me natyrë kushtetuese të konstatuara gjatë këtij gjykimi, Gjykata vëren se trashëgimlënësi i kërkuar fillimisht i është drejtuar AKKP-së për njohjen dhe kthimin e pronës sipas ligjit nr. 9235/2004 dhe me vendimin nr. 240/2007, ajo ka vendosur përfundimisht mosnjohjen e pronës, ndërsa ka konstatuar se ishte disponuar më parë nga KKKP-ja, Durrës për njohjen e kthimin e saj në favor të një subjekti tjetër, Komunitetit Mysliman. Pas kësaj, trashëgimlënësi i kërkuar ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe me padinë e paraqitur ka kërkuar anulimin e



vendimit nr. 205/1/1997, të KKKP-së, Durrës të dhënë në favor të Komunitetit Mysliman, si dhe detyrimin e këtij të fundit për të njohur pronarë trashëgimtarët e A.H. për pasurinë truall me sipërfaqe 1034 m². Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se: i. paditësi nuk legjitimohej për kundërshtimin e vendimit nr. 205/1/1997, të KKKP-së, Durrës, për sa kohë ai dhe trashëgimtarët e tjerë të A.H. nuk kanë ushtruar, brenda afatit ligjor, të drejtën e ankimit, sipas nenit 18, të ligjit nr. 9235/2004, kundër vendimit nr. 240/2007 të AKKP-së, me të cilin është disponuar për mosnjohjen e së drejtës së pronës; ii. në mungesë të një kërkitimi në padi, ajo nuk mund të shqyrtonte kryesisht pavlefshmërinë e vendimit nr. 240/2007 të AKKP-së; iii. pretendimin e pronësisë paditësi e mbështetet vetëm mbi një vendim gjyqësor për vërtetim fakti të vitit 1955, ndërkohë që nuk kishte një akt shpronësimi, i cili të vërtetonte marrjen e pronës nga shteti pas datës 29.11.1944 dhe, për më tepër, i padituri, Komuniteti Mysliman, dispononte dokumentacion origjinal për vërtetimin e pronësinë, dokumentacion ky që është më i saktë në aspektin ligjor.

24. Mbi ankimin e paditësit (trashëgimlënësi i kërkuësve), gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar në të njëjtën linjë si ajo se pala paditëse nuk ka arritur të provonte interesin e ligjshëm, në kuptim të nenit 32 të KPC-së, për kundërshtimin e vendimit nr. 205/1/1997, të KKKP-së, Durrës, për sa kohë nuk ka kundërshtuar gjyqësisht, sipas ligjit nr. 9235/2004, vendimin nr. 240/2007 të AKKP-së, i cili ka rrëzuar kërkesën e trashëgimtarëve të A.H. për njohjen dhe kthimin e pronës, vendim ky i cili ka marrë formë të prerë, përveçse as në objektin e padisë nuk ka kërkitim për kundërshtimin e këtij vendimi. Sipas asaj gjykate, pala paditëse nuk mund të pretendojë ndaj të tretëve, përfshirë Komunitetin Mysliman, të drejta reale në zbatim të ligjit nr. 9235/2004, pa goditur më parë vendimin nr. 240/2007 të AKKP-së, që nuk i ka njohur asaj të drejtën e pronësisë. Ndërkohë, ajo gjykatë nuk ka vlerësuar themelin e pretendimeve në padi në lidhje me të drejtën e pronës.

25. Për rekursin e kërkuësve, të cilët janë bërë pjesë e procesit gjyqësor në gjykimin e çështjes në apel për shkak se trashëgimlënësi i tyre ka ndërruar jetë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me

arsyetimin se ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

26. Nga sa më lart, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje nga trashëgimlënësi i kërkuësve me një padi për njohjen e pronësisë, në kuadër të së cilës është kërkuar edhe anulimi i vendimit nr. 205/1/1997, të KKKP-së, Durrës, në bazë të të cilit prona mbahej nga i padituri (subjekti i interesuar), Komuniteti Mysliman. Pavarësisht natyrës dhe llojit të kësaj padie, gjykata e shkallës së parë e ka rrëzuar atë, duke parashtruar argumente të natyrës procedurale, por edhe substanciale. Ndërkohë, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke konsideruar vetëm argumentet e natyrës procedurale. Kurse Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve, praktikisht ka vlerësuar të ligjshëm vendimin e gjykatës së apelit.

27. Gjykata vëren se rregullat për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile, ku bën pjesë edhe ajo për të drejtën reale të pronësisë, përcaktohen nga KPC-ja. Sipas kësaj të fundit, në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile (*neni 36*), pra ato mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me të drejta subjektive që burojnë nga e drejta private, ndër to edhe e drejta reale e pronësisë. Ky kod ngarkon gjykatën me detyrimin për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor (*neni 14*) dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, të detyrueshme për t'u zbatuar prej saj (*neni 16*).

28. Në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronës, Gjykata është shprehur se ai lindi si një nevojë për të vendosur drejtësinë sociale për arsye se individët ishin zhveshur nga prona në përputhje me legjislacionin e kohës, por në kundërshtim me elementet bazë të së drejtës të shteteve demokratike, në të cilat e drejta e pronës private njihet dhe mbrohet nga rendi juridik dhe se, në këto kushte, individëve të ndryshëm, të cilët ishin privuar nga e drejta e pronës gjatë regjimeve totalitare, u lindi e drejta që të kërkonin të viheshin në të njëjtat pozita juridike në lidhje me pronën, siç kishin qenë përpara shtetëzimit. Sipas saj, kërkesa e një personi përpara organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave synon njohjen e së drejtës së pronës për një send të caktuar, e cila është një e drejtë subjektive dhe jo një interes i ligjshëm i tij, në kuptim të nenit 32 të KPC-së, ndërsa ajo rregullohet nga KC-ja, duke qenë jashtë fushës së veprimt të së



drejtës publike. Gjykata ka theksuar se vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, ndër vite, nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte administrative, por, përkundrazi, shtetasi në gjykatë, në një gjykim të zakonshëm, kërkon të drejtën e pronës, duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte dhe se shqyrtimi i saj mund të bëhet vetëm nga gjykata e zakonshme, në përputhje me KC-në (*shih vendimin nr. 27, datë 26.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata, po ashtu, vëren se për sa i përket ligjit nr. 9235/2004, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese, ka bërë interpretimin unifikues/njësues të tij, interpretim ky i detyrueshëm jo vetëm për gjykatat më të ulëta, por edhe për vetë atë. Konkretisht, në vendimin unifikues nr. 2, datë 21.1.2011, Gjykata Lartë ka arritur në përfundimin se në zbatim të ligjit nr. 9235/2004, subjektet e shpronësuara nuk kanë detyrim për t'iu drejtuar rrugës përkatëse administrative nëse për të njëjtën pronë, ish-KKKP-ja ose AKKP-ja, kanë disponuar më parë për njohjen e kthimin e saj një subjekti tjetër të shpronësuar, raste në të cilat çështja i përket juridiksionit gjyqësor. Edhe në vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, Gjykata Lartë, ndërsa ka rikonfirmuar qëndrimin e saj si më lart, ka arritur në përfundimin se në gjykimet me objekt kundërshtimin e vendimit të KKKP-së ose AKKP-së, kemi të bëjmë me të drejta subjektive dhe vendimet e tyre nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte të mirëfillta administrative, se subjekti kërkuar në një gjykim të zakonshëm kundërshton vendimin e KKKP-së ose AKKP-së dhe kërkon të drejtën e pronës, duke paraqitur prova në mbështetje të së drejtës së tij të pronësisë, ndërkohë që gjykata zhvillon një gjykim themeli lidhur me titullin e pronësisë, duke ndryshuar ose shfuqizuar vendimin e KKKP-së ose AKKP-së, si dhe duke zgjidhur në themel këtë konflikt pronësie.

30. Për sa i përket së drejtës së ankimit në gjykatë për vendimet e AKKP-së, Gjykata vëren se ligji nr. 9235/2004, sipas përmbajtjes së tij në momentin kur AKKP-ja ka disponuar me vendimin nr. 240/2007, për mosnjohjen e së drejtës së pronësisë për trashëgimlënësin e kërkuarve, ndërsa ka parashikuar një të drejtë të tillë për subjektet e shpronësuara, nuk ka përcaktuar afate për ushtrimin e saj. Një afat i tillë në këtë ligj, konkretisht 30 ditë, është parashikuar në

nenin 18 të tij vetëm pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009, dispozitë e cila duket se është zbatuar në rastin konkret nga gjykatat e zakonshme. Kjo dispozitë e ligjit i është nënshtruar kontrollit kushtetues dhe Gjykata është shprehur se ai rregullon çështjen e aksesit në gjykatë dhe afatin ligjor për të kundërshtuar vendimet e AKKP-së. Gjykata ka vlerësuar se gjykata që zgjidh çështjen ka të gjithë hapësirën e nevojshme që t'u referohet normave ligjore në fuqi për zgjidhjen e saj, më konkretisht dispozitave përkatëse të KPC-së, dhe se, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Nga sa më lart, Gjykata konstaton se mosmarrëveshja e parashtruar përpara gjykatave të zakonshme lidhet me të drejtën e pronësisë, ndërsa padia e kërkuarve për njohjen e kësaj të drejte është rrëzuar përfundimisht nga gjykata e apelit me argumente të natyrës procedurale, pa e shqyrtuar atë në themel, zgjidhje e cila është vlerësuar e pacenueshme nga Gjykata e Lartë. Ato gjykata kanë anashkaluar faktin se prona objekt mosmarrëveshjeje i është njohur dhe kthyer më parë Komunitetit Mysliman, duke qenë ky shkaku i asaj vendimmarrjeje të AKKP-së në disfavor të kërkuarve (trashëgimlënësit të tyre), ndërkohë që pikërisht për këtë shkak mosmarrëveshja mes palëve për të drejtën e pronësisë është bërë pjesë e juridiksionit gjyqësor. Në situatën konkrete të rastit, kërkuar (trashëgimlënësi i tyre) as kanë pasur detyrimin për të ndjekur rrugën administrative për njohjen dhe kthimin e pronës, sikundër as vendimi i AKKP-së për kërkesën e tyre nuk mund çonte në humbjen e së drejtës së pronësisë dhe as të kushtëzonte ushtrimin nga ata të së drejtës së padisë për kërkimin e pronës. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, me jurisprudencën kushtetuese dhe atë unifikuese/njësuese të Gjykatës së Lartë, ata i janë drejtuar rrugës gjyqësore për të kërkuar të drejtën e pronësisë, duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte, porse gjykatat e zakonshme nuk kanë zhvilluar një gjykim themeli lidhur me titullin e pronësisë, duke mos e zgjidhur në themel konfliktin e pronësisë mes palëve. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykatat e zakonshme duket se faktin e mosnjohjes së të drejtës së pronës nga AKKP-ja, për shkak se ishte disponuar më parë nga KKKP-ja, Durrës, për njohjen e kthimin e saj në



favor të një subjekti tjetër (të paditurit në proces), e kanë interpretuar se mund të passjellë humbjen e kësaj të drejte për kërkesit. Po kështu, ato, duket se faktin e moskundërshtimit në objektin e padisë nga kërkesit të atij vendimi të AKKP-së, e kanë interpretuar si arsye të mjaftueshme për rrëzimin e padisë pa e shqyrtuar atë në themel. Kjo mënyrë e interpretimit të këtyre fakteve, në vlerësim të Gjykatës, duket e paarsyeshme në këndvështrimin kushtetues dhe në pikëpamje të së drejtës, duke pasur në konsideratë se pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër (me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në KC), ose kur hiqet dorë prej saj, si dhe se rrëzimi i padisë nga gjykata nënkupton pathemelësinë e saj, pas zhvillimit të një procesi gjyqësor në lidhje me mosmarrëveshjen e paraqitur asaj për zgjidhje.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se gjetjet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, sa u përket fakteve dhe interpretimit të ligjit, nuk janë objektivisht të justifikueshme dhe të arsyeshme, për sa kohë nuk marrin në konsideratë as qëndrimet unifikuese/njësuere, ndaj vendimet e tyre nuk përmbushin funksionin e një vendimi të drejtë nga pikëpamja e arsyetimit. Po kështu, duke mos e shqyrtuar padinë e kërkesve në themel, pra duke mos u dhënë përgjigje për pretendimet në lidhje me të drejtën substanciale të pronës, ato gjykata u kanë cenuar atyre të drejtën e aksesit në gjykatë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkesve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, është i bazuar.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkesve janë pjesërisht të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet pranuar pjesërisht, vetëm sa i përket vendimit të gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimi i vendimeve nr. 204/10-2015-506, datë 4.3.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 00-2023-3019, datë 13.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
Marrë më 29.10.2024.
Shpallur më 4.12.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 77, datë 5.11.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 5.11.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (S) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Sose Buçpapaj

SUBJEKT I INTERESUAR:

Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, Edmond Rrushi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1209/3, datë 19.11.2014, të Komisionit të Disiplinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; nr. 1491, datë 23.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1213



(1197), datë 23.3.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-33, datë 11.1.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 23, 33, 42, 43, 48, 118, pika 3, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 137, 140, pika 2, shkronja “a” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6, 13, 14 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71, 71/a dhe 71/b, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (*AKU*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja ka ushtruar detyrën e inspektorese së ushqimit në drejtorinë rajonale të AKU-së, Kukës, konkretisht “inspektore në sektorin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë me origjinë shtazore e operatorëve të biznesit”, ndërkohë që më parë ka kryer detyra të ndryshme pranë këtij institucioni. Kontrata mes saj dhe AKU-së është lidhur në datën 10.8.2012, me afat të pacaktuar.

2. Në datën 30.6.2014, disa subjekte tregtare, veprimtaria e të cilave është kontrolluar nga AKU-ja, Kukës, i janë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së me petition, duke kërkuar ndërhyrjen e institucionit për zgjidhjen e problematikave të shkaktuara nga komunikimi jo i rregullt i kërkuases. Në datën 3.7.2014, drejtuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së i është drejtuar drejtorit të drejtorisë rajonale Kukës për verifikimin e ankesës së paraqitur nga operatorët e biznesit. Për këtë

qëllim, ky i fundit ka vendosur ngritjen e një grupi pune, bazuar në gjetjet e të cilit në datën 24.10.2014 i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së për ngritjen e komisionit disiplinor dhe fillimin e procedurës për marrjen e masës disiplinore ndaj kërkuases, si rrjedhojë e konstatimit të shkeljeve të rënda dhe shumë të rënda të kryera prej saj gjatë ushtrimit të detyrës. Në datën 5.11.2014, kërkuësja është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor, si dhe për zhvillimin e seancës dëgjimore. Kjo e fundit është zhvilluar në datën 12.11.2014, ku kërkuësja ka qenë e pranishme, ka parashtruar argumentet e saj, si dhe është shprehur se observacionet për çështjen do t'i depozitonte me shkrim.

3. Në përfundim të diskutimeve në seancën e datës 19.11.2014, me vendimin nr. 1209/3, datë 19.11.2014, të dhënë në prani të kërkuases, komisioni disiplinor ka vendosur marrjen ndaj saj të masës disiplinore “*Largimi nga shërbimi civil*”, ndërsa me urdhrin nr. 1209/4 prot., datë 24.11.2014, të drejtorit të AKU-së është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës, duke filluar nga data 24.11.2014.

4. Në datën 24.12.2014, kërkuësja ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës (*Prokuroria Kukës*) ndaj kolegëve të saj, duke i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, pika 2, i Kodit Penal (*KP*), me pretendimin se kishin falsifikuar të dhënat e procesverbaleve të inspektimit të disa subjekteve të kontrolluara më parë prej saj, të cilat në vijim ishin konstatuar si shkelje të saj. Në kushtet e moskompetencës së kësaj prokurorie, çështja i ka kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, e cila ka vendosur kalimin e saj për gjykim. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka vendosur deklarinimin të pafajshëm të të akuzuarve. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa për rekursin e prokurorisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin. Kërkuësja i është drejtuar në vijim Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar, për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, të aksesit të lidhur me të drejtën për t’u mbrojtur, ankimit efektiv, marrjes së provës në mënyrë të paligjshme, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit



të arsytimit të vendimit dhe parimit të sigurisë juridike. Me vendimin nr. 67, datë 5.4.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të moslegjitimitetit *ratione personae* të kërkuës, pasi interesi i saj substancial në çështje lidhet me procesin gjyqësor administrativ, i cili ishte ende në shqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

5. Po kështu, paralelisht me procesin penal, në datën 30.12.2014, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi për shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ nr. 1209/4 prot., datë 24.11.2014, të AKU-së, rikthimin e saj në detyrën e mëparshme dhe pagesën e pagës deri në momentin e rikthimit në detyrë. Me vendimin nr. 1491, datë 23.3.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

6. Kërkuësja ka ushtruar ankim kundër këtij vendimi. Në përfundim të shqyrtimit të tij, me vendimin nr. 1213 (1197), datë 23.3.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e gjetur atë të drejtë e të bazuar në ligj.

7. Kërkuësja ka ushtruar rekurs ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Me vendimin nr. 00-2024-33, datë 11.1.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se: i. ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (ligji nr. 49/2012); ii. në të nuk ngriheshin pretendime se vendimet e gjykatave më të ulëta binin ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të saj; si dhe se iii. vendimet ishin marrë në zbatim të drejtë të ligjit.

8. Në datën 11.4.2024, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27, të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.4.2024. Në datat 27.5.2024 dhe 28.5.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me kërkesa për përjashtimin e katër gjyqtarëve kushtetues, për të cilat, me vendimet e datave 10.6.2024 dhe 25.6.2024, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin. Në vijim, në datën 21.6.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e

Gjyqtarëve, ndërsa në datën 10.7.2024, kjo e fundit ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. Kërkuësja, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

9.1 E drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

9.1.1 Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi:

9.1.1.1 Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë paragykuar çështjen, duke nxjerrë qëllimisht konkluzione të gabuara se ajo nuk kishte përmbushur detyrat e saj funksionale. Gjyqtarja e gjykatës së shkallës së parë ka bërë rolin e avokates së AKU-së, ndërsa ka trajtuar formalisht provat e paraqitura nga kërkuësja. Gjykata e apelit nuk ka vlerësuar qëllimisht faktin e marrjes në përgjegjësi penale të 4 ish-kolegëve të kallëzuar penalisht prej saj, si dhe aktekspertimin e Policisë Shkencore për falsifikimin prej tyre të dokumenteve, ndërsa Gjykata e Lartë ka zhdukur qëllimisht praktikën në lidhje me kërkesën e saj për përjashtimin e relatorit, gjyqtarit S.S. Vendimi nr. 1, datë 4.4.2023, i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës së saj për përjashtimin e këtij gjyqtari është marrë nën ndikimin e tij.

9.1.1.2 Gjykata e shkallës së parë ka shkelur qëllimisht nenin 297/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pasi nuk ka vendosur pezullimin e gjykimit, ndonëse ishte vënë në dijeni se për thelbin e konfliktit kërkuësja kishte paraqitur kallëzim penal. Sipas procesverbalit të seancës, të mbajtur qëllimisht nga gjykata në kundërshtim me urdhrin nr. 359, datë 5.9.2013, “Për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore apo të veprimeve të tjera procedurale që zhvillohen jashtë seance” të ministrit të Drejtësisë (urdhri nr. 359/2013 i ministrit të Drejtësisë), rezulton se kërkuësja ka pranuar zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, ndërkohë që ajo i kishte kërkuar gjykatës marrjen e provave nga AKU-ja, kërkesë kjo që nuk është marrë parasysh. Një pjesë e mirë e provave nuk janë administruar në fashikullin gjyqësor ose janë zhdukur. Këto veprime janë bërë me qëllim të paracaktuar për rrëzimin e kërkesës së saj.

9.1.1.3 Ndonëse ishte caktuar si relator, gjyqtari i Gjykatës së Lartë S.S. nuk ka marrë pjesë në trupin



gjykues për shqyrtimin e çështjes së saj pikërisht për shkak të konfliktit të interesit. Shqyrtimi i rekursit është zvarritur qëllimisht nga ky gjyqtar.

9.1.2 Së drejtës për t'u njoftuar, për të marrë pjesë, për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova e për t'u asistuar, si dhe së drejtës për ankim efektiv, pasi nuk është vënë në dijeni për shkeljet e pretenduara nga eprori direkt, në cenim të nenit 23, pika 1, të Kushtetutës. Në cenim të akteve ligjore në fuqi, shkresa e këtij të fundit për fillimin e procedurës disiplinore nuk i është drejtuar komisionit disiplinor në AKU, por Drejtorisë së Përgjithshme të këtij institucioni, në shkelje të nenit 118, pika 3, të Kushtetutës. Po kështu, ajo nuk është lejuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga komisioni i disiplinës. Gjykatat e faktit nuk kanë pranuar provat e kërkuases dhe pretendimet e saj nuk janë marrë parasysh prej tyre. Seancat gjyqësore janë zhvilluar vetëm formalisht, pa prezencën e AKU-së. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancë plenare me praninë e palëve, me qëllim që AKU-ja t'u përgjigjej pyetjeve mbi bazën e fakteve dhe provave që tregonin se largimi i saj nga detyra ishte bazuar në akte të falsifikuara.

9.1.3 Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi ndonëse i është drejtuar Gjykatës së Lartë me 3 kërkesa për përshpejtimin e gjykimit, çështja e saj është gjykuar nga kjo gjykatë më vonë se çështje të tjera të regjistruara më pas. Mendimi i këshilltarit ligjor për trajtimin e çështjes me përparësi nuk është marrë parasysh.

9.1.4 Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në rastin e saj janë respektuar procedurat e parashikuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil, ndërkohë që në prapësimet e veta AKU-ja ka argumentuar se zgjidhja e kontratës së punës është bërë në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës. Kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkuasesja. Vendimet gjyqësore të të tria shkallëve janë arsyetuar vetëm formalisht, mbi bazën e provave të paraqitura nga AKU-ja, ndërkohë që gjykatat nuk kanë analizuar asnjë provë të saj. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar shtesën e rekursit të kërkuases, parashtrimet e datës 12.6.2020, kërkesën e datës 13.12.2023 dhe kërkesën paraprake urgjente të datës 15.12.2023, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës së saj për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore në prani të palëve. Kjo gjykatë është mjaftuar me një arsyetim gjysmë faqe.

9.2 Së drejtës për t'u informuar, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për dorëheqjen e relatorit S.S. ose shkaqet e kësaj dorëheqjeje, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës së saj të datës 8.11.2023, për arsyet e mospërshejimit të gjykimit të çështjes ose kërkesave për shkaqet e zhdukjes ose fshehjes së praktikës në lidhje me kërkesën për përjashtim të gjyqtarit S.S. Vendimi nr. 1, datë 4.4.2023, i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës së saj për përjashtimin e gjyqtarit S.S. nuk ndodhet në dosjen administrative.

9.3 Së drejtës për të marrë dokumentacionin e kërkuar, të garantuar nga neni 48 i Kushtetutës, pasi prej 10 vjetësh është shkelur e drejta e saj për të marrë procesverbalet e inspektimit, sipas përmbajtjes së konstatuar nga raporti i auditit nr. 3741/1 prot., datë 5.9.2014. Ndonëse ka kërkuar marrjen e këtyre procesverbaleve nga gjykata e shkallës së parë, kërkesa është rrëzuar me vendim të ndërmjetëm të gjykatës. Po kështu, ndonëse kishte një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për marrjen e këtyre procesverbaleve nga AKU-ja, as shërbimi përmbarimor, as strukturat antikorrupsion nuk kanë arritur të mundësojnë vënien e tyre në dispozicion të saj.

9.4 Parimit të sigurisë juridike dhe parimit të mosdiskriminimit, pasi largimi i saj nga detyra ka qenë i padrejtë.

9.5 Subjekti i interesuar, AKU-ja, ka prapësuar se pretendimet e kërkuases janë shqyrtuar nga gjykatat, të cilat kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Ato kanë bërë një analizë tërësore dhe objektive të provave, duke i vlerësuar në bazë të bindjes së tyre të brendshme. Zgjidhja e mosmarrëveshjes është bërë në përputhje me nenin 116 të KPC-së. Po kështu, gjykatat u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuases, në garantim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*. Gjykata e apelit ka argumentuar në mënyrë shteruese pretendimet e saj, duke interpretuar saktë ligjin e zbatueshëm material nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" (*ligji për nëpunësin civil*), si dhe duke pasur në vëmendje edhe praktikën e Gjykatës së Lartë.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuës

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, individ duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, ndër të tjera, edhe si rrjedhojë e zhvillimit të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë në mungesë të AKU-së. Për sa i përket këtij pretendimi, Gjykata vëren se, në thelb, ai ka të bëjë me të drejtat procedurale të personave të tjerë, ndaj kërkuësja nuk legjitimohet *ratione personae* në lidhje me të, pasi nuk ka provuar të drejtën e cenuar për këtë shkak dhe interesin e ligjshëm vetjak të saj. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata çmon se kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin

administrativ dhe atë gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuësja ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Nga shqyrtimi i akteve që kërkuësja i ka bashkëlidhur ankimit individual kushtetues dhe akteve të dosjes gjyqësore, Gjykata konstaton se në to nuk gjendet ndonjë kërkesë e kërkuësjes drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procesit bazuar në nenet 399/1 e vijues KPC-së. Për këto të fundit, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se janë mjete juridike që ofrojnë rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese dhe vetëm pasi t’i ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen prej tyre nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, individ mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuësja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për pasojë pretendimi i saj për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Në lidhje me pretendimin e kërkuësjes për cenimin e parimit të mosdiskriminimit, Gjykata evidenton se në dosjen gjyqësore të tërhequr për qëllime të gjykimit kushtetues rezulton e



administruar një ankesë e saj drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kundër vendimit të largimit të saj nga puna. Pavarësisht këtij fakti, nuk ka ndonjë të dhënë nëse ky ankim i është dërguar Komisionerit ose që në lidhje me të të ketë një qëndrim të këtij të fundit. Po kështu, çështja e diskriminimit rezulton të jetë shtruar për herë të parë në kërkesën paraprake urgjente të datës 15.12.2023, drejtuar Gjykatës së Lartë, në drejtim të largimit të padrejtë nga puna pa shkaqe të ligjshme dhe nuk rezulton të jetë ngritur në gjykatat e faktit, për pasojë nuk ka një qëndrim të tyre për këtë pretendim të saj. Në këto kushte, edhe në lidhje me këtë pretendim, Gjykata çmon se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës.

16. Për sa i takon pretendimit se gjykata e shkallës së parë nuk e ka mbajtur procesverbalin e seancës nëpërmjet regjistrimit audio, konform parashikimeve të urdhrit nr. 359/2013 të ministrit të Drejtësisë, Gjykata vëren se kërkesja ka qenë e pranishme gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe ka marrë dijeni për mënyrën e mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore. Në datën 18.5.2015, ajo i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për vënien në dispozicion të materialeve të dosjes gjyqësore, ndërkohë që në ankimin drejtuar kësaj gjykate, por edhe gjatë procesit në Gjykatën Administrative të Apelit nuk ka ngritur ndonjë pretendim në këtë drejtim, duke e parashtruar atë për herë të parë në shtesën e rekursit drejtuar Gjykatës së Lartë, ndaj Gjykata vlerëson se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion edhe për këtë pretendim, për rrjedhojë ai nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit fillimisht të procesit administrativ dhe më pas atij gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimit të organit administrativ dhe vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i

cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata evidenton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 11.1.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 11.4.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae* kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, së drejtës për t’u njoftuar, për të marrë pjesë, për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për t’u asistuar, për ankim efektiv, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, parimit të sigurisë juridike, si dhe së drejtës për t’u informuar e së drejtës për të marrë informacionin e kërkuar.

20. Pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, kërkesja e ka ngritur në disa drejtime duke parashtruar se: i. gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kërkesën e saj për pezullimin e gjykimit, nuk ka marrë parasysh kërkesën e saj për të detyruar AKU-në për të paraqitur prova, nuk ka pranuar provat e depozituara nga kërkesja, si dhe nuk ka mbajtur procesverbalin e seancës sipas urdhrit nr. 359/2013 të ministrit të Drejtësisë; ii. gjykata e apelit nuk ka vlerësuar qëllimisht aktin e ekspertimit të kryer gjatë procedimit penal; iii. Gjykata e Lartë ka zhdukur qëllimisht praktikën në lidhje me kërkesën e saj për përjashtimin e relatorit, gjyqtarit S.S. dhe vendimi nr. 1, datë 4.4.2023, i kësaj gjykate për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e këtij gjyqtari është marrë nën ndikimin e këtij të fundit.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Sipas Gjykatës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në



dysim paanshmërinë (*shih vendimet nr. 64, datë 1.10.2024; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 10, datë 13.2.2017; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, Gjykata çmon se pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si rrjedhojë e mospezullimit të gjykimit të çështjes nga gjykata e shkallës së parë, për shkak të procesit penal të iniciuar nga kërkuesja ndaj kolegëve të saj, janë të pabazuara, pasi kërkuesja ka pasur mundësinë që gjatë gjykimit administrativ të parashtronte edhe pretendimet e saj për falsitetin e provave, për të cilat ka vënë në lëvizje procesin penal, sipas rregullave procedurale civile të zbatueshme për këtë qëllim. Ndërsa, pretendimet e tjera të parashtruara në lidhje me paanshmërinë e gjykatave të faktit kanë të bëjnë me vlerësimin nga këto gjykata të fakteve dhe provave, çka nuk i përket juridiksionit kushtetues. Gjithashtu, pretendimet për ndikimin e gjyqtarit S.S. në marrjen e vendimit nr. 1, datë 4.4.2023, përmes të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës për përjashtim e tij, nuk rezultojnë të argumentuara në këndvështrimin kushtetues, ndërsa për sa i takon praktikës për përjashtimin e këtij gjyqtari, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesja, kërkesa e saj dhe vendimi nr. 1, datë 4.4.2023 i Gjykatës së Lartë janë administruar në dosjen gjyqësore të kësaj gjykate. Për më tepër, Gjykata vëren se për sa i përket trupës gjyqësore që ka shqyrtuar rekursin e saj, me vendimin nr. 15, datë 20.6.2023, të Këshillit të Gjykatës së Lartë, për shkak të emërimit të një gjyqtari të ri në atë gjykatë, është vendosur ndryshimi i trupës së kolegjit administrativ të kësaj gjykate, duke përcaktuar si anëtarë të saj gjyqtarët A.V., A.A. dhe E.M. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se

pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme janë të haptazi të pabazuara *ratione materiae*.

24. Kërkuesja ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si rrjedhojë e mosshqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë në seancë gjyqësore me prani të palëve. Në lidhje me të, Gjykata vë në dukje se sipas nenit 61, të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, ndërsa shqyrtimi në seancë gjyqësore vendoset në rastet e parashikuara nga neni 62 i këtij ligji. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit, mbi bazë dokumentesh, është forma e gjykimit që ndiqet si rregull tashmë në Gjykatën e Lartë dhe se e drejta për t'u dëgjuar nuk konsiderohet e cenuar vetëm për shkak të shqyrtimit prej saj të çështjes në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr. 23, datë 4.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje përmes rekursit të paraqitur nga kërkuesja, në të cilin ka parashtruar pretendimet e saj për vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta, duke iu dhënë në këtë mënyrë e drejta për t'u dëgjuar para kësaj gjykate. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesja nuk ka arritur të përcaktojë se si shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Po kështu, në ankimin kushtetues individual kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u informuar, për shkak se nuk është informuar për dorëheqjen e gjyqtarit relator në Gjykatën e Lartë, S.S., për shkaqet e zhdukjes ose fshehjes së praktikës për kërkesën për përjashtimin e këtij gjyqtari, si dhe shkaqet e mospërshepjimit të gjykimit të çështjes nga kjo gjykatë.

26. Gjykata vëren se kërkesa e kërkueses për përjashtimin e gjyqtarit S.S. është depozituar në Gjykatën e Lartë në datën 27.3.2023, ndërsa me vendimin nr. 15, datë 20.6.2023, të Këshillit të Gjykatës së Lartë është ndryshuar përbërja e Kolegjit Administrativ të kësaj gjykate që kishte për shqyrtim çështjen e kërkueses, ku gjyqtari S.S. nuk rezultoi më pjesë e tij. Ky vendim rezultoi i publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Gjykata çmon se edhe pse kërkueses mund të mos i jetë njoftuar vendimi për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit S.S., ky fakt nuk



i ka cenuar asaj ndonjë të drejtë kushtetuese, për sa kohë ai gjyqtar nuk ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar rekursin e saj. Prandaj edhe ky pretendim i kërkuësës nuk gjen mbështetje në këndvështrimin kushtetues dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

27. Gjykata konstaton, gjithashtu, se në vendimin nr. 1-00-2023, datë 4.4.2023, të gjyqtarës së vetme të Gjykatës së Lartë, kërkuësja ka marrë përgjigje edhe për pretendimet e saj për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes. Kështu, gjyqtarja ka arsyetuar se ndërsa palët kanë të drejtë që, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “*Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit*”, të kërkojnë përshpejtimin e gjykimit të çështjes, vendimi i gjyqtarit për këtë kategori kërkesash kufizohet vetëm në disponim pranues ose refuzues, pa qenë e nevojshme që qëndrimi të arsyetohet hollësisht. Bazuar në nenet 482 dhe 460 të KPC-së, gjyqtari planifikon çështjen për gjykim, duke mbajtur në konsideratë radhën e ardhjes së saj në gjykatë. Po sipas gjyqtarës, përjashtimisht kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të një çështjeje jashtë kësaj radhe lejohet vetëm për shkaqe të rënda e të motivuara, të cilat mbeten në vlerësimin e gjyqtarit (*shih faqet 2–3, paragrafi 8, të vendimit nr. 1-00-2023, datë 4.4.2023, të Gjykatës së Lartë*). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se edhe pretendimet e kërkuësës për mosinformimin për shkaqet e mospërshpejtimit të gjykimit të rekursit të saj nuk gjejnë mbështetje në aspektin kushtetues.

28. Në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi prej 10 vjetësh është në pamundësi të marrjes së procesverbaleve të inspektimit, sipas përmbajtjes së tyre të konstatuar nga raporti i auditit. Gjykata e çmon të pabazuar këtë pretendim, pasi sipas materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, konkretisht shkresës nr. 3880/1 prot., datë 25.9.2020, të AKU-së; kthim-përgjigjes nr. 1732/1 prot., datë 12.5.2021, e AKU-së; shkresës nr. S-96, datë 3.3.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion të Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se AKU-ja ka vënë në dispozicion të saj materialin e kërkuar. Për më tepër, ky fakt përbën një ndër kërkimet e saj gjatë procesit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe gjykatat i kanë dhënë përgjigje, duke arsyetuar se ajo i dispononte procesverbalet e pretenduara dhe

kishte refuzuar t’ia dorëzonte ato AKU-së, duke i administruar si personale (*shih faqen 8 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*); mosdorëzimi i tyre së bashku me shkeljet e tjera të konstatuara përbënin shkelje të rëndë të detyrës (*shih faqen 18 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*); pretendimet në lidhje me këto prova dëlnin jashtë funksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih faqen 13, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuësës nuk mund të merret në shqyrtim.

29. Po kështu, për sa i takon pretendimit të kërkuësës për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata vëren se ai është parashtruar në mënyrë të përgjithshme, pa u përcaktuar se në ç’drejtëm është cenuar, ndaj çmon se kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë cenimin e tij në aspektin kushtetues.

30. Për sa u përket pretendimeve të tjera për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar, për të marrë pjesë, për t’u dëgjuar, për t’u asistuar, për ankim efektiv, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh argumentet në thelb të tyre, Gjykata çmon t’i analizojë ato në vijim në drejtëm të së drejtës për t’u dëgjuar gjatë procesit administrativ dhe atij gjyqësor të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

31. Kërkuësja ka pretenduar se ajo nuk është vënë në dijeni për shkeljet e pretenduara nga eprori direkt dhe nuk është lejuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga komisioni i disiplinës. Shkresa për inicimin e procedurës disiplinore nuk i është drejtuar komisionit disiplinor në AKU, por Drejtorisë së Përgjithshme të këtij institucioni, ndërkohë që fillimi i ecurisë disiplinore duhej të ishte bërë nga eprori direkt dhe jo nga komisioni disiplinor. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh provat dhe pretendimet e saj në këtë drejtëm dhe vendimet e tyre janë arsyetuar vetëm formalisht. Në prapësimet e veta AKU-ja ka argumentuar se zgjidhja e kontratës së punës është bërë në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës. Po sipas kërkuësës, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar shtesën e rekursit të saj, parashtrimet e saj të datës 12.6.2020, kërkesën e saj të datës 13.12.2023 dhe kërkesën paraprake urgjente të datës 15.12.2023, si dhe nuk i ka dhënë



përgjigje kërkesës për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore me prani të palëve.

32. Subjekti i interesuar, AKU-ja, ka prapësuar se pretendimet e kërkuases janë shqyrtuar nga gjykatat e faktit, të cilat kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes. Gjykatat kanë bërë një analizë tërësore dhe objektive të provave, duke i vlerësuar ato në bazë të bindjes së tyre të brendshme. Zgjidhja e mosmarrëveshjes është bërë në përputhje me nenin 116 të KPC-së. Po kështu, gjykatat u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuases, në garantim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

33. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Sipas Gjykatës, kur ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij mënyrën se si kanë vepruar organet e pushtetit publik, atëherë kontrolli kushtetues ushtrohet për të verifikuar nëse organi administrativ ka përmbushur detyrimet ligjore në atë masë që të jetë respektuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe, në vijim, nëse gjykatat e zakonshme, që kanë shqyrtuar veprimet dhe vendimmarrjen e organit administrativ, kanë vepruar në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është në radhë të parë funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, Gjykata ka pohuar se kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që përpara marrjes së vendimit gjyqësor të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 7, datë 12.3.2010; nr. 12, datë 6.6.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin

e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se mospasqyrimi në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë i shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në shtesën e rekursit, përbën cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, në rastin konkret Gjykata do të vlerësojë nëse gjatë procesit administrativ kërkuases i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar për pretendimet e saj përpara nxjerrjes nga organi administrativ të urdhrit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe nëse vendimmarrja e këtij organi është vlerësuar nga gjykatat në kuadër të garancive që ofron neni 42 i Kushtetutës për proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim do të analizohet nëse gjykatat kanë marrë në shqyrtim pretendimet e saj në këndvështrim të së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

37. Gjykata vëren se, sipas materialeve të dosjes gjyqësore, me shkresën nr. 1209, datë 5.11.2014, të AKU-së kërkuessa është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor. Po kështu, sipas procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 12.11.2014 nga komisioni disiplinor, rezulton se kërkuessa ka qenë e pranishme në këtë seancë, ku dhe ka depozituar një sërë dokumentesh, ndërkohe që ka refuzuar të nënshkruajë procesverbalin e mbajtur. Në datën 19.11.2014 komisioni është mbledhur për të votuar në lidhje me çështjen, duke u shprehur se në përfundim të procesit kërkuessa do të njoftohej në lidhje me rekomandimet ose vendimin e marrë. Me vendimin nr. 1209/3 të po kësaj date, të dhënë në prani të kërkuesses, komisioni disiplinor ka vendosur marrjen ndaj saj të masës



disiplinore “Largimi nga shërbimi civil” (*shih faqet 47, 394–398, 409 dhe 420–421 të dosjes gjyqësore*).

38. Në kërkesëpadinë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe argumentet ligjore përfundimtare të saj në këtë gjykatë kërkesja ka pretenduar, ndër të tjera, se në procedimin administrativ nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil, pasi ajo nuk është lejuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga komisioni i disiplinës, duke dërguar në këto kushte pretendimet e saj me postë. Po sipas saj, shkresa e eprorit direkt për fillimin e procedurës disiplinore nuk i është drejtuar komisionit disiplinor në AKU, por Drejtorisë së Përgjithshme të këtij institucioni, ndërkohë që fillimi i ecurisë disiplinore duhej të ishte bërë nga eprori direkt dhe jo nga komisioni disiplinor. AKU-ja ka prapësuar se lidhja e kontratës së punës është bazuar në dispozitat e Kodit të Punës dhe njoftimi i saj për bisedime në lidhje me vazhdimin e kësaj kontrate dhe për seancën dëgjimore në lidhje me ecurinë disiplinore është bërë në përputhje me dispozitat e këtij kodi.

39. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke vlerësuar se vendimi i komisionit të disiplinës ishte marrë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, në respektim të procedurës së parashikuar në ligjin për statusin e nëpunësit civil dhe parimit të dëgjimit. Po sipas gjykatës, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit barra e provës për të provuar ligjshmërinë e aktit ose veprimit i takon organit administrativ, AKU-ja ka paraqitur vendimin nr. 1209/4, datë 24.11.2014, në të cilin pasqyrohet prezenca e kërkeses. Kërkesja ka pretenduar se nuk ka qenë e pranishme në gjykimin administrativ, ndërkohë që, në zbatim të parimit të procedurës civile, sipas të cilit pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin që në përputhje me ligjin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimet e saj, ajo nuk ka arritur të provojë gjatë gjykimit pretendimet se nuk ishte lejuar të merrte pjesë në seancën dëgjimore të komisionit disiplinor dhe nuk kishte paraqitur prova direkte ose indirekte që provonin këtë fakt (*shih faqet 7–9 të vendimit nr. 1491, datë 23.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

40. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është gjetur i drejtë nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vlerësuar se në zhvillimin e procedurës disiplinore AKU-ja nuk ka shkelur kërkesat

procedurale të parashikuara nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në fuqi. Kërkesja është njoftuar për fillimin e procedurës disiplinore, duke iu dhënë mundësia të parashtronte pretendimet e saj. Gjatë hetimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë ka rezultuar e provuar se ajo ka qenë prezent në seancën e datës 12.11.2014, të zhvilluar nga komisioni disiplinor, gjatë së cilës ka parashtruar pretendimet e saj, ndonëse nuk ka pranuar të nënshkruajë procesverbalin e mbajtur. Po kështu, ajo ka qenë e pranishme edhe në seancën e datës 19.11.2014, fakt ky që rezulton nga përmbajtja e vendimit të komisionit disiplinor. Nga ana tjetër, ndonëse shkresa për fillimin e procedurës disiplinore nuk i është drejtuar shprehimisht komisionit disiplinor, fakti që i është drejtuar AKU-së nënkupton se i është drejtuar këtij komisioni, si organi disiplinor me kompetencën e zhvillimit të procedurës disiplinore, sipas pikës 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 5.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, e cila përcakton se në rastet e shkeljeve të lehta ecuria disiplinore iniciohet nga eprori, ndërsa në rastet e shkeljeve të rënda, siç është dhe rasti i saj, nga komisioni disiplinor (*shih faqet 10–13 të vendimit nr. 1213 (1197), datë 23.3.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit*).

41. Kërkesja ka ushtruar rekurs në datën 24.4.2017, duke ngritur, në thelb, të njëjtat pretendime që ka ngritur para gjykatave të faktit. Po kështu, në datën 12.6.2020, ajo ka depozituar parashtrime në Gjykatën e Lartë, ku ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk ka urdhëruar paraqitjen e provave nga pala tjetër, administrimi i të cilave ka qenë i rëndësishëm për gjykimin e çështjes, ndërsa në datën 17.3.2022, ka paraqitur shtesë rekursi, duke parashtruar se disa seanca gjyqësore janë zhvilluar vetëm formalisht, pasi pala e paditur është paraqitur vetëm në seancën e parë; një pjesë e provave nuk janë administruar në dosjen gjyqësore, ndërsa të tjera janë zhdukur pa u inventarizuar; ato janë vlerësuar nga gjykatat vetëm formalisht; procesverbali i seancës gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë është falsifikuar dhe kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj për marrjen e provave nga AKU-ja; veprimet e gjyqtarës janë bërë me qëllim të paracaktuar për rrëzimin e kërkesës së saj; gjykata e apelit nuk ka marrë në



konsideratë e vlerësuar provat e reja të dërguara nga kërkuesja, të cilat ishin zhdukur nga dosja gjyqësore e gjykatës së shkallës së parë, si dhe nuk ka vlerësuar provat shkencore që provonin falsifikimin e dokumenteve; AKU-ja dhe gjykatat nuk kanë vënë në dispozicion të kërkueses provat e kërkuara prej saj; Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së nuk i ka vënë në dispozicion procesverbalet e inspektimit, sipas përmbajtjes së tyre të konstatuar nga raporti i auditit, çka tregon se ky raport ka qenë fiktiv dhe i falsifikuar; gjykata e apelit është treguar e njëanshme ndaj saj, duke e paragjykuar.

42. Po kështu, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë në datën 13.12.2023, duke kundërshtuar vendimin nr. 01-00-2023, datë 4.4.2023, të gjyqtarës së vetme të kësaj gjykate, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës së saj për përjashtimin e gjyqtarit S.S. nga gjykimi i çështjes. Në këtë kërkesë ajo ka kërkuar edhe gjykimin e çështjes nga gjykata në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Ndërsa, në kërkesën urgjente të datës 15.12.2023, kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të mosdiskriminimit, si rrjedhojë e largimit të saj nga puna pa shkaqe të ligjshme, si dhe ka ripërsëritur argumentet e parashtruara në rekurs e ato të parashtruara në kërkesat e depozituara në vijim të tij.

43. Me vendimin nr. 00-2024-33, datë 11.1.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Sipas këtij kolegji, pretendimet e kërkueses janë shqyrtuar nga gjykatat e faktit, të cilat kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimit të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Në përputhje me parashikimet e nenit 126 të KPC-së, gjykatat kanë bërë analizë tërësore dhe objektive të provave, duke i vlerësuar ato në bazë të bindjes së tyre të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësi i rrethanave të çështjes, duke zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Po kështu, në interpretim të drejtë të ligjit material për statusin e nëpunësit civil, gjykata e apelit ka arsyetuar në mënyrë shteruese për të gjitha pretendimet e kërkueses të parashtruara në rekurs. Nga ana tjetër, pjesa e pretendimeve që ngrenë çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj (*shih faqet 12–13 të vendimit nr. 00-2024-33, datë 11.1.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

44. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykata vëren se nga

dokumentacioni i dosjes gjyqësore rezulton se gjatë procesit administrativ kërkueses i është dhënë mundësia për t'u njohur me faktet që e kanë ngarkuar me përgjegjësi administrative, si dhe të paraqesë argumente e prova në mbështetje të pretendimeve të saj, në garantim të së drejtës për t'u dëgjuar përgjatë këtij procesi. Po kështu, Gjykata vë në dukje se pretendimet në lidhje me këtë proces janë parashtruar nga kërkuesja edhe gjatë procesit gjyqësor. Gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është zhvilluar në prani të kërkueses dhe përfaqësuesit të saj ligjor, i cili ka parashtruar pretendimet e saj, përfshirë edhe ato për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar gjatë procesit disiplinor. Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë janë vënë në lëvizje përmes ankimit dhe rekursit të kërkueses, ku janë parashtruar argumentet e saj për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar gjatë procesit administrativ. Pretendimet e kërkueses në këtë drejtim janë analizuar dhe vlerësuar nga gjykatat përkundrejt parashikimeve të ligjit material e procedural dhe gjykatat kanë arsyetuar qëndrimet e tyre në lidhje me to, ndaj për sa i takon të drejtës së kërkueses për t'u dëgjuar gjatë procesit administrativ, Gjykata çmon se vendimmarrja e gjykatave rezulton në respektim të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

45. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është arsyetuar në mënyrë të kufizuar, duke u formuluar në mënyrë standarde. Një arsyetim i tillë është pranuar nga jurisprudenca kushtetuese si në përputhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë që në pjesën hyrëse pasqyrohen shkaqet e ngritura në rekurs. Gjykata thekson se ky element është i rëndësishëm në rastin e arsyetimit të kufizuar të vendimit, pasi u tregon palëve se janë dëgjuar dhe çështja e tyre është vlerësuar nga Gjykata e Lartë. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se në vendimin e Gjykatës së Lartë janë pasqyruar shkaqet e parashtruara nga kërkuesja në rekurs në lidhje me procesin administrativ, ndërkohë që nuk kanë gjetur pasqyrim shkaqet e parashtruara prej saj në shtesën e rekursit, parashtrimet dhe në kërkesat e tjera të paraqitura në Gjykatën e Lartë, edhe pse në thelb ato kishin të bënin me cenimin e së drejtës për punë të kërkueses, të garantuar në nenin 49 të Kushtetutës, në aspektin procedural (procesi administrativ dhe gjyqësor i zhvilluar) dhe atë substancial. Në zbatim të standardit të arsyetimit të vendimit, Gjykata vëren



se paraqitja e pretendimeve të ngritura në shtesën e rekursit, si dhe në kërkesat e parashtrimet e tjera të paraqitura nga kërkuuesja duhej të ishin evidentuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, qoftë edhe për të analizuar nëse ato ishin paraqitur apo jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.

46. Nga sa më sipër, Gjykata çmon se mungesa në vendimin e Gjykatës së Lartë të të gjitha pretendimeve të ngritura nga kërkuuesja në të gjitha aktet e paraqitura përpara Gjykatës së Lartë cenon jo vetëm standardin e një vendimi të arsyetuar, por ka vënë në dyshim edhe të drejtën e kërkueses për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e saj. Në vlerësimin e Gjykatës, është detyrë e Gjykatës së Lartë që, si gjykatë ligji, të arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, pretendimet e ngritura në shtesën e rekursit në rastet kur ato kanë të bëjnë me të drejta kushtetuese.

47. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "F" dhe 134, pika 1, shkronja "I", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-33, datë 11.1.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 5.11.2024.

Shpallur më 5.12.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj (kundër)

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Genti Ibrahim, Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 8 (S) 2024 të Regjistrat Themeltar, që i përket kërkueses Sose Buçpapaj, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 1209/3, datë 19.11.2014, të Komisionit të Disiplinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; nr. 1491, datë 23.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1213 (1197), datë 23.3.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-33, datë 11.1.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*", jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar për shkak të pabazueshmërisë së pretendimeve të kërkueses. Për këtë arsye çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Fillimisht, çmojmë të evidentojmë se ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket trajtimit në përgjithësi të pretendimeve të kërkueses, me përjashtim të atij për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me mospasqyrimin në vendimin e Gjykatës së Lartë të shkaqeve të parashtruara nga kërkuuesja në parashtrimet, shtesën e rekursit dhe në kërkesat e tjera të paraqitura nga ajo në atë gjykatë, shkak për të cilin shumica ka arritur në përfundimin se vendimi i asaj gjykate cenon jo vetëm standardin e një vendimi të arsyetuar, por vë në dyshim edhe të drejtën e kërkueses për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e saj. Sipas shumicës, është detyrë e Gjykatës së Lartë që, si gjykatë ligji, të arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, pretendimet e ngritura në shtesën e rekursit në rastet kur ato kanë të bëjnë me të drejta kushtetuese, ndërsa ato në rastin konkret, në thelb, kishin të bënin me cenimin e së drejtës për punë të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, në aspektin procedural (procesi administrativ dhe gjyqësor i zhvilluar) dhe atë substancial (*shih paragrafët 45–46 të vendimit*).

3. Ne, gjyqtarët në pakicë, nuk pajtohemi me këtë vlerësim të shumicës. Për këtë mbajmë në konsideratë faktet në lidhje me parashtrimet, shtesën e rekursit dhe kërkesat e tjera të paraqitura nga kërkuuesja në Gjykatën e Lartë, sikurse ato janë pasqyruar kronologjikisht dhe në mënyrë të përmbledhur edhe nga shumica (*shih paragrafin 41 të vendimit*), në referim të të cilave mund të analizohet se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit mban



datën 23.3.2017 dhe kërkesja, brenda afatit ligjor 30-ditor, sipas nenit 44, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*) dhe nenit 443, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka ushtruar rekurs në datën 24.4.2017. Në vijim, në datën 12.6.2020, pra pas më shumë se 3 vjetëve nga vendimi i gjykatës së apelit, kërkesja ka depozituar në Gjykatën e Lartë parashtrime. Më tej, pas 5 vjetëve nga vendimi i gjykatës së apelit, në datën 17.3.2022, kërkesja ka depozituar në atë gjykatë një shtesë rekursi. Më tej akoma, pas gati 7 vjetësh nga vendimi i gjykatës së apelit, në datën 13.12.2023, kërkesja ka depozituar në Gjykatën e Lartë një kërkesë dhe po ashtu, në datën 15.12.2023, ka depozituar edhe një kërkesë tjetër.

4. Nga sa më lart, rezulton se parashtrimet, shtesa e rekursit dhe kërkesat e tjera të paraqitura nga kërkesja në Gjykatën e Lartë datojnë shumë vite pas kalimit të afatit ligjor për ushtrimin e së drejtës së rekursit. Dispozitat procedurale civile në lidhje me mjetet dhe afatet e ankimit, që aplikohen edhe në gjykimin administrativ, kanë parashikuar rekursin si mjetin e ankimit në Gjykatën e Lartë (neni 442 i KPC-së), afati ligjor i paraqitjes së të cilit është 30 ditë (neni 443 i KPC-së), afat ky që sipas ligjit procedural të kohës (neni 444 i KPC-së) fillonte nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar. Po ashtu, dispozitat procedurale parashikojnë se shkaqet e rekursit janë përcaktuese për kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga ajo gjykatë (neni 473/a). Referuar këtyre rregullimeve ligjore, kohëzgjatja e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë nuk nënkupton dhe as mund të shërbejë si shkak për t'i dhënë palës rekursuese të drejtën për të paraqitur pretendime ose shkaqe të reja për kundërshtimin e procesit gjyqësor në gjykatat e faktit, të ndryshme apo përtej atyre të parashtruara në rekurs dhe as për të zgjeruar kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë.

5. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 18, datë 31.3.2014; nr. 17, datë 19.6.2009, të Gjykatës*

Kushtetuese). Po ashtu, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se nuk është arbitrar interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë për papranueshmërinë e shtesës së rekursit, interpretim sipas të cilit, bazuar në nenin 473/a të KPC-së, ajo e shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit, përveç rasteve kur ligji i jep të drejtën të investohet kryesisht, ndërkohë që në kushtet kur shqyrtimi gjyqësor kufizohet vetëm brenda shkaqeve të parashtruara në rekurs, shkaqet e reja të parashtruara në shtesën e rekursit nuk mund të merren në vlerësim, pasi për shkak të ligjit janë të papranueshme (*shih vendimin nr. 30, datë 18.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Për rrjedhojë, vetëm fakti i mosevidentimit në rastin konkret nga Gjykata e Lartë i paraqitjes nga kërkesja të parashtrimeve, shtesës së rekursit dhe kërkesave të tjera dhe mosarsyetime minimalist nga ajo i papranueshmërisë së tyre për shkak të paraqitjes së tyre dukshëm jashtë afatit ligjor për atë mjet ankimi, pavarësisht faktit nëse në ato akte janë parashtruar ose jo pretendime të reja të ndryshme nga ato në rekurs dhe të lejuara nga ligji, në vlerësimin tonë nuk mund të përbëjnë shkak për të arritur në përfundimin e cenimit nga Gjykata e Lartë të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe as mund të vënë në dyshim të drejtën e kërkeses për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e ngritura në ato akte. Edhe duke pranuar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka mangësi formale në këtë aspekt, një mangësi e tillë kurrsesi nuk mund të çojë në një përfundim të ndryshëm në lidhje me të drejtat kushtetuese të pretenduara si të cenuara nga kërkesja. Në këtë drejtim vlen të përmendet se në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Për sa më lart, mbajtem qëndrimin se pretendimet e kërkeses në tërësi ishin të pabazuara, ndaj kërkesa e saj duhet të rrëzohej.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Genti Ibrahim, Ilir Toska



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024



Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë